

CALL YOUR COUNTRY
 FOL ME VENDIN TËND
 DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.
WIND
 Informacione në wind.it




E PËRMUAJSHME/MENSILE VITI/ANNO VI NR.6 - GIUGNO/QRSHOR 2009 - € 1,50

shqiptari i italisë

l'albanese d'italia

CALL YOUR COUNTRY
 FOL ME VENDIN TËND
 DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.
WIND
 Informacione në wind.it

BOTA SHQIPTARE - Il Mondo Albanese Edizioni - Redazione Viale Marco Polo 119, 00154 Roma - Tel 06.57289240 Fax 06.62209543



Uria e Ermalit

Nga periferitë e artit të pavarur italian këtë qershor do të nxjerrë kryet një bandë emri i së cilës kritikët bëjnë bé se do do t'i dëgjohet shumë larg. Kanë një emër të çuditshëm, "La Fame di Camilla". Dhe një kokë kryesore, shqiptarin Ermal Meta. I cili nuk ngurron të përfshijë në albumin e saponxjerrë nga Universal edhe një këngë në shqip.



LIGJI SIGURISË Emigrantët në shenjstër

Me ligjin më të fundit të miratuar në Dhomën e deputetëve, emigrantët në Itali, qofshin të rregullt apo të parregullt, do ta kenë jetën më të vështirë. Të gjitha risitë



SAIMIR PIRGU Veç me emrat e mëdhenj

"Woody Allen qe thjesht një përvojë e bukur që më dha edhe më shumë vizibilitet mediatic, Por unë jam e do të mbetem tenor. Kam punuar me dirigjentë maestro të mëdhenj të muzikës klasike si Abbado, Muti, Harnacourt, dhe ndihem me fat."



WESTERN UNION
 MONEY TRANSFER

Vodafone One Nation New

Që sot vendlindja jote është më afër






Ministero per le Pari Opportunità



Ufficio Nazionale
Antidiscriminazioni Razziali

Viktimë e racizmit?



Telefono falas NË NUMRIN E GJELBËR
800.90.10.10

JETË E PAMUNDUR PA LEJEQËNDRIMI

Me ligjin e ri futet në kodin penal italian vepra penale e hyrjes dhe e qëndrimit klandestin, që nuk do të dënohet me burg por me gjobë nga 5.000 deri në 10.000 euro dhe me dëbim të menjëhershëm (parashikohet edhe mundësia e dëbimit pa lëshimin e autorizimit nga autoritetet kompetente). Gjithashtu ligji fut edhe detyrimin për të huajt që të paraqesin lejen e qëndrimit për çdo veprim me administratën publike, përfshirë "ato që kanë të bëjnë me aktet e gjendjes civile", gjë që praktikisht ndalon martesat e të huajve klandestinë në Itali, por jo vetëm kaq. Dyshimet për moskushtetutshmëri të këtyre dy pikave janë të shumta dhe vijnë nga vetë gjykatësit. Futja e veprës penale të emigracionit klandestin, praktikisht detyron të gjithë ata që kryejnë detyrën e një zyrtari shtetëror të denoncojnë cilindo klandestin me të cilin bien në kontakt.

Pas debatesh të shumta, dhe për të mos shkelur hapur kushtetutën, ky detyrim iu hoq mjekëve, për t'u dhënë mundësi klandestinëve të kurohen, dhe drejtuesve të shkollave, për t'u dhënë mundësinë e shkollimit bijve të emigrantëve të parregullt. Por mbetet problemi interpretues i ligjit: kush nuk duhet t'i përmbahet detyrimit të paditjes së emigrantit klandestin? Vetëm mjekët dhe drejtuesit e shkollave apo i gjithë personeli i strukturave shëndetësore dhe i shkollave?

Për pikën e dytë që ka të bëjë me detyrimin e paraqitjes së lejes së qëndrimit, dyshimi më i madh që lind është: a do të mund të regjistrojë në Zyrën e gjendjes civile të birin e sapolindur një nënë klandestine? Për ministrin e Brendshëm Maroni, një dyshim i tillë i të majtës nuk qëndron pasi nënat shtatzëna kanë të drejtën e lejes së qëndrimit deri sa fëmija të bëhet gjashtë muajsh. Ndërsa për gjykatësin kushtetues Mirabella, norma

I miratuar më 14 maj në Dhomën e deputetëve, ligji mbi "Dispozita në lidhje me sigurinë publike", i njohur ndryshe me emrin "paketa e sigurisë", i shkruar nga qeveria dhe mazhoranca e qendrës së djathtë, me Legën në krye, thuasë pa dyshim do të marrëedhe miratimin përfundimtar të Senatit brenda qershorit. Italia do të ketë kështu një ligj të ri që do të modifikojë një sërë normash mbi emigracionin në këtë vend.

Kush mbështet ligjin e ri, shprehet se ishte i domosdoshëm për të luftuar seriozisht emigracionin klandestin pas vitesh të tëra politikash të pafrytshme. Kush e kritikon ligjin denoncon se me ardhjen e tij në fuqi emigrantët do të kthehen në qytetarë të dorës së dytë, të cilëve do t'u duhet të respektojnë një sërë normash raciste dhe çnjerezore. Një gjë është e sigurt, jeta e emigrantëve do të bëhet edhe më e vështirë. E të gjithëve, me ose pa dokumentin e qëndrimit. Nëse klandestinët do të kenë të bëjnë me krimin e klandestinitetit, ndalimin e martesave, qëndrim shumë më të gjatë në qendrat e identifikimit e të dëbimit, emigrantët e rregullt do të kenë të bëjnë me lejen me pikë, dhe do t'u duhet të paguajnë shumë më shtrenjtë se sot për përtëritjen e lejes së qëndrimit dhe për shtetësinë.



Me ligjin e ri futet në kodin penal italian vepra penale e hyrjes dhe e qëndrimit klandestin, që nuk do të dënohet me burg por me gjobë nga 5.000 deri në 10.000 euro dhe me dëbim të menjëhershëm

mund të jetë vërtet jokushtetuese sepse "përbën shtrëngim të të drejtave të njeriut: një grua shtatzënë, duke ditur që rrezikon të dëbohet brenda gjashtë muajve nga lindja e fëmijës, kushtëzohet në ushtrimin e të drejtës së saj të padiskutueshme siç është njohja e fëmijës". Po ashtu edhe detyrimi i pasjes së lejes së qëndrimit për martesë "paraqet kufizim të tepruar, sepse për të shmangur marte-

sat për interes, është zgjatuar koha e nevojshme për kërkimin e shtetësisë, nga gjashtë muaj në dy vjet".

Pasi hidhet poshtë dy herë me radhë, një herë në Senat e njëherë tjetër në Dhomën e deputetëve në brendësi të diskutimit të dekretit të ligjit nr. 11, qeveria, këtë herë në brendësi të një amendamenti të blinduar nga votëbesimi, fut më në fund normën mbi zgjatjen e kohës maksimale të qëndrimit të klandestinëve në Cie: nga dy muaj që është sot, në gjashtë muaj. Kjo normë do të jetë e vlefshme jo vetëm për klandestinët që do të hyjnë pas ardhjes në fuqi të këtij ligji, por edhe për të gjithë ata që gjenden në këto qendra në atë çast.

Të huajt e parregullt hasin probleme, e veçanërisht qira më të larta, kur kërkojnë një vend ku të fusin kokën sepse ata që u japin shtëpi me qira të huajve të parregullt për "të pasur fitim të padrejtë" rrezikojnë 3 vjet burg dhe konfiskimin e shtëpisë. Më e vështirë edhe që t'u dërgojnë para familjarëve, pasi këtej e tutje pikat që kryejnë transferimin e parave e kanë të detyruar t'u kërkojnë klientëve lejen e qëndrimit dhe të ruajnë një kopje për dhjetë vjet. Në rast se klienti është klandestin duhet të lajmërojnë autoritetet; po të mos e bëjnë rrezikojnë licencën.

ke.bi.

LIGJI I SIGURISË

EMIGRANTËT
NËN.
SHENJESTËR

Me ligjin më të fundit të miratuar në Dhomën e deputetëve, emigrantët në Itali, qofshin të rregullt apo të parregullt, do ta kenë jetën më të vështirë. Të gjitha risitë



GODITJE EDHE PËR EMIGRANTËT E RREGULLT

Ligji i ri parashikon një "mar-rëveshje integrimi" të artikuluar në pikë, që i huaji duhet të nënshkruajë në çastin e kërkesës së lejes së qëndrimit. Ndryshe mund të themi që të huajt do të kenë një lejeqëndrim me pikë që shtohen ose hiqen sipas sjelljes së tyre. Kush mbaron pikët, humbet të drejtën e lejes së qëndrimit dhe dëbohet. Ende nuk dihet konkretisht se cilat janë shkeljet për të cilat i huaji humbet pikë dhe se si mund t'i rifitojë ato, këto gjëra do të vendosen më pas me një rregullore të posaçme.

Për paraqitjen e kërkesave lidhur me marrjen e lejeqëndrimit të parë dhe përtëritjen e tij do të paguhet një taksë e re, e quajtur "kontribut ekonomik", që do të jetë nga 80 deri në 200 euro. Shifra e saktë do të vendoset më pas me vendim të ministrisë së Brendshme dhe asaj të Punës.

Gjysma e parave do t'i shkojë Fondit për riatdhesimet e të parregulltve (edhe pse nuk kuptohet pse duhet të penalizohen emigrantët e rregullt) ndërsa gjysma tjetër ministrisë së Brendshme me shpresën që, me gjithë këto para më shumë, ajo të jetë e aftë që të mund të reduktojë kohën e dhënies së një përgjigjeje. Nuk themi të jepen brenda afatit të përcaktuar me ligj, por të paktën pritja të mos jetë sfillitëse si sot, e të mos jepen dokumente në prag të skadimit. Aq më tepër kur një risi tjetër është paraqitja e kërkesës për përtëritje të lejes së qëndrimit të paktën 60 ditë para skadimit të saj (më parë, përtëritja

mund të kërkohej deri 60 ditë pas skadimit).

Një tjetër kontribut parashikohet edhe për kërkesat e shtetësisë. Shuma në këtë rast është vendosur: për çdo kërkesë për shtetësinë italiane do të paguhet 200 euro taksë.

Shtrengime të tjera të futura me këtë ligj, për marrjen e dokumenteve janë edhe kalimi i një testi gjuhe si kusht shtesë për të fituar të drejtën e kartës së qëndrimit, si dhe zgjatja nga gjashtë muaj në dy vjet e kohës së nevojshme të martesës me një shtetas italian para paraqitjes së kërkesës për shtetësi. Një tjetër risi është edhe futja e ndëshkimit me një vit burg dhe gjobë deri në 2.000 euro, për ata që edhe pse të rregullt nuk u tregojnë dokumentin e qëndrimit zyrtarëve të shtetit që ua kërkojnë. Praktikiisht, nëse deri më sot, mospasja me vete e lejes së qëndrimit mund të të shkaktonte humbjen e disa orëve në një komisariat, këtej e tutje mund të të kushtojë shumë më shtrenjtë.

I huaji duhet t'i kërkojë kuestorit të provincës përtëritjen e lejes së qëndrimit të paktën 60 ditë para përfundimit të afatit të dokumentit të ka në dorë.

Regjistrimi apo ndryshimi i rezidencës në Zyrën e gjendjes civile mund të sjellë edhe verifikimin nga anë e zyrave kompetente të komunës të kushteve higjienike-sanitare të banesës. Në këtë rast versioni fillestar i tekstit është zbutur disi, pasi parashikonte që për regjistrimin e

vijon në faqen 4

IN ITALIANO

Il vero comanchero

Arjol Kondi

Oggi mi sono fermato davanti a un famosissimo manifesto elettorale. Uno di quelli che letteralmente "fa paura". Quello famoso con l'immagine di un indiano con la bella illustrazione "loro hanno subito l'immigrazione e ormai vivono nelle riserve". Che vergogna! Ma chi ha ideato questa pubblicità ha qualche nozione di storia? Io non credo!

Gli indigeni delle americhe non hanno subito nessuna immigrazione ma un'invasione. I primi che sono sbarcati nelle loro coste erano soldati armati di fucili e canoni in cerca di oro e altri oggetti preziosi. I nuovi arrivati controllavano le frontiere, emanavano le leggi, amministravano la giustizia e avevano il diritto all'utilizzo della forza.

Invece, gli immigrati in Italia sono arrivati armati di umiltà, cazzuola, piccone e tanta voglia di lavorare accanto agli italiani. Non sono scesi dalle navi da guerra, semmai da qualche carretta del mare; non sono scesi in terra italiana per appropriarsi dei beni di chi già viveva in questo territorio ma a lavorare insieme e continuare a fare crescere questo paese.

Gli immigrati in Italia non condizionano in nessuna maniera l'emanazione delle leggi. Il legislatore non ha mai chiesto il parere di qualche immigrato quando ha svolto il suo dovere, ne anche quando le leggi riguardavano gli immigrati (e abbiamo come risultato che allo zoppo viene messo un ulteriore peso

sulle spalle invece di alleggerirlo un po'). Gli immigrati non godono di nessun privilegio nell'amministrazione della giustizia se non quelli di cui gode ogni persona in quanto tale. Nessun immigrato può dire quando viene fermato dalle forze dell'ordine quella simpatica frase "Non sai chi sono io? io sono figlio di... o nipote di..." perché nella sua famiglia non c'è nessun magistrato, sindaco, consigliere regionale o onorevole. Suo padre è come lui, un operaio che se è fortunato ha ancora il lavoro e il permesso di soggiorno in corso di validità.

L'immigrato non può ne anche permettersi di dire che ha subito violenza da qualche pubblico ufficiale perché la sua parola non vale in nessun modo quanto la parola del pubblico ufficiale. E per fortuna, nel caso del ragazzo di colore a Parma, che i vigili che hanno abusato della divisa che indossavano, sono stati così imbecilli da scrivere sulla busta degli effetti personali del ragazzo "Emanuel Negro" sennò, povero lui, si beccava anche una bella denuncia per calunnia.

E sarebbe questa l'armata che metterebbe gli italiani nelle riserve? Ma smettiamola di spargere paure inutili! Nessuno è venuto qua con una pistola. Chi lo ha fatto lo abbiamo chiamato tutti insieme DELINQUENTE. Non rendete la vita difficile a chi già soffre! Non spaventate le persone con dicerie e visioni macabre che dimorano solo nel vostro cervello!

Io mi auguro tanto per me e per chi vive in Italia che dietro quei manifesti non si nasconda qualcuno di quelle persone che negli stati uniti andavano in giro con i cappucci a cono e coperti di lenzuolo bianco, perché adesso a subire sono io, ma domani quando io non ci sarò tocca a te ITALIANO!



Il manifesto della Lega Nord che invita a "pensare" sull'immigrazione per non fare la fine degli indigeni d'America

Emigrantët nën shenjës

vijon nga faqja 3

rezidencës të kërkohej automatikisht certifikata e përshtatshmërisë së banesës. Edhe kështu siç u miratua, kjo normë mund të sjellë probleme, dhe jo vetëm për të huajt por edhe për vetë italianët, pasi shumë prej banesave që jepen me qira, edhe të lartë, nuk përmbushin kushtet higjienike-sanitare të parashikuara me ligj, dhe kjo do të sjellë mosregjistrimin e rezidencës dhe për pasojë edhe humbjen e të drejtës së regjistrimeve të fëmijëve në kopshtet e komunës, pamundësinë e përfitimit të kompensimeve në mbështetje të rrogave të ulëta e të tjera.

Për të huajt parashikohet gjithashtu edhe heqja e rezidencës gjashtë muaj pas datës së përfundimit të afatit të lejes së qëndrimit: praktikisht pas çdo përtëritjeje të lejes i huaji duhet të shkojë e të konfirmojë rezidencën e tij.

Këtë e tutje nuk do të jetë më e mundur të kërkohej viza e hyrjes për një familjar nëse Sporteli Unik nuk përgjigjet për 180 ditë me lëshimin apo refuzimin e autorizimit (nulla osta) për bashkim familjar. Në këtë mënyrë zhduket edhe e vetmja mundësi garancie e të drejtës së njësisë familjare, e parashikuar për t'i bërë ballë ngadalësisë burokratike.

Një tjetër risi shtrënguese për bashkimet familjare është që këtë e tutje Sporteli Unik do të kërkojë jo vetëm certifikatën e përshtatshmërisë së strehimit por edhe certifikatën igjienike-sanitare, të dyja të marra pranë zyrave të komunës. Në këtë mënyrë u jepet sërish mundësia e arbitrarishtit komunave të vendosin kritere të posaçme që duhet të përmbushin banesat e të huajve në mënyrë që të kenë të drejtën të bashkojnë familjen.

ke.bi.

BASHKIMET FAMILJARE


Kaos për sigurimin shëndetësor të prindërve të sjellë me bashkim familjar

Sipas ministrisë së Punës siguriimi nevojitet vetëm për ata që kanë ardhur pas 5 nëntorit 2008, për ministrinë e Brendshme edhe për të gjithë të tjerët

Nga nëntori i shkuar, me futjen në fuqi të dekretit legjislativ 160/2008, janë rritur kërkesat për bashkimin familjar. Përveç të ardhurave që nevojiten më të larta se më parë, e përveç faktit që prindërit mund të sillen vetëm nëse nuk kanë në atdhe të tjerë bij ose, kur janë mbi 65 vjeç, nëse bijtë e tjerë nuk mund t'i mbajnë "për arsye të rënda dhe të dokumentuara shëndetësore". Për më tepër, për mbi 65-vjeçarët është i detyrueshëm siguriimi shëndetësor privat ose regjistrimi me pagesë në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar (SSN). Për mundësinë e dytë të sigurimit shëndetësor, pranë SSN-së, qeveria ende nuk ka vendosur sa duhet të jetë shuma për t'u paguar, ndaj edhe sot e kësaj dite, pas shtatë muajve nga hyrja në fuqi e kësaj norme, e vetmja mundësi mbetet siguriimi shëndetësor privat i prindërve.

Kështu për të gjithë prindërit e ardhur në Itali pas 5 nëntorit 2008 nevojitet siguriimi. Po për ata që kanë ardhur përpara kësaj date e të cilët përtëritjnë lejen e qëndrimit, a duhet kërkuar apo jo ky siguriim? Këtu lindin paqartësitë.

Sipas një qarkoreje të 4 majit të ministrisë së Punës thuhet qartë: "shtetasi i huaj me leje qëndrimi për motive familjare të lëshuar para 5 nëntorit 2008, me mbushjen e 65 vjeçeve ka të drejtën e regjistrimit të de-



tyrueshëm (falas) në Shërbimin shëndetësor Kombëtar ose të ruajtjes së regjistrimit të mëparshëm në bazë të nenit 34 të dekretit legjislativ 286/98. Dispozitat e reja (për sigurimin shëndetësor me pagesë) duhet t'u referohen vetëm të ardhurve me bashkim familjar pas 5 nëntorit 2008". Duket sheshit që kush ka ardhur në Itali para 5 nëntorit 2008, ka fituar të drejtën e regjistrimit në SSN, ndaj për këta, në çastin e përtëritjes së dokumentit nuk duhet të kërkohej siguriimi privat shëndetësor.

Tjetër gjë thuhet në qarkoren e ministrisë së Brendshme të katër ditëve më pas, 8 majit: "lidhur me problemin e ngritur mbi domosdoshmërinë apo jo të lidhjes së sigurimit shëndetësor për prindërit mbi 65 vjeç në çastin e përtëritjes së lejeqëndrimit, Departamenti i Sigurisë publike shprehet që të interesuarit duhet të tregojnë dokumentin që dëshmon lidhjen e sig-

Një kuriozitet i vogël. A e dini për çfarë duhet të sigurohen privatisht prindërit mbi 65 vjeç? Në qarkoren e ministrisë së Brendshme të 17 shkurtit 2009 thuhet shprehimisht: "duhen konsideruar të vlefshme - ashtu si për shtetasit e huaj që vijjnë për studime - siguriimet shëndetësore që mbulojnë reziqet e sëmundjeve, të fatkeqësive dhe të shtatzënisë". Sa prej nesh kanë nëna mbi 65 vjeç që "rrezikojnë të mbesin shtatzëna"?

urimit shëndetësor, ashtu siç u kërkohej atyre që hyjnë për herë të parë në territorin kombëtar". Pra, për ministrinë e Brendshme, të gjithë prindërit mbi 65 vjeç të sjellë në Itali me bashkim familjar, pavarësisht nga data e hyrjes, duhet të sigurohen me pagesë për shëndetin e duhet të tregojnë dëshminë në çastin e përtëritjes së lejes së qëndrimit.

Kujt i duhet besuar? Ministrisë së Brendshme apo asaj të Punës?

Një kuriozitet i vogël. A e dini për çfarë duhet të sigurohen privatisht prindërit mbi 65 vjeç? Në qarkoren e ministrisë së Brendshme të 17 shkurtit 2009 thuhet shprehimisht: "duhen konsideruar të vlefshme - ashtu si për shtetasit e huaj që vijjnë për studime - siguriimet shëndetësore që mbulojnë reziqet e sëmundjeve, të fatkeqësive dhe të shtatzënisë". Sa prej nesh kanë nëna mbi 65 vjeç që "rrezikojnë të mbesin shtatzëna"? (ke.bi.)

BOTIM I / EDITORE Edizioni Bota shqiptare srl - (Il mondo albanese)

REDAKSIA / REDAZIONE

Viale Marco Polo 119, 00154 ROMA

Tel 06-57289240 Fax 06-62209543 Cell. 339-3798796

Regjistruar në Regjistrin e Shtypit të Gjykatës së Romës.

BOTA SHQIPTARE É ISCRITTO AL REGISTRO STAMPA DEL TRIBUNALE DI ROMA AL nr. 213/99 del 12/05/1999.

www.botashqiptare.net redaksia@botashqiptare.net

DREJTOR BOTIMI / DIRETTORE EDITORIALE Roland Sejko KRYEREDAKTOR / CAPOREDATTORE Arta Bardhi REDAKTORË / IN REDAZIONE Keti Biçoku, Albana Temali, Marjola Rukaj

NË BASHKËPJUNIM ME / IN COLLABORAZIONE CON Edizioni Stranieri in Italia

STAMPA: Centro Stampa Quotidiani S.p.A - via dell'Industria 52 - 25030 Erbusco (BS)

shqiptari i italisë

l'albanese d'italia

e përmuajshme suplement i

Bota shqiptare

gazeta e shqiptarëve në itali



Vodafone One Nation New

Që sot, vendlindja jote është më afër.

**Një tarifë e vetme për Italinë dhe për vendin tënd.
15 qindarka në minutë përgjithmonë.**

Aktivizo falas Vodafone One Nation New dhe do të kesh 1000 minuta në muaj për të komunikuar me vendlindjen tënde duke paguar përgjithmonë vetëm 15 qindarka. Për informacione mbi planin dhe vendet në të cilat aplikohet kjo tarifë, lutemi të vizitoni faqen e internetit www.vodafone.it

Tarifa paguhet përpara 60 sekondave të parë të telefonatës dhe ka vlerën 15 qindarka. Shuma e paguar në momentin e përgjigjes është 16 qindarka.

Life is now



ROMA



"Shumë nulla osta mbeten të patërhequra"

Alarm në Romë: Është e vështirë të kontaktosh ata që kanë bërë kërkesë për bashkime familjare.

Më shumë informacione për publikun nga sporteli unik i imigracionit të Romës, falë hapjes pasdite. Çdo të mërkurë në via Ostiense 131, mund të merren informacione për flukset e hyrjes dhe bashkimet familjare nga ora 9 në 13, dhe nga ora 14.30 në 17.00.

Duke paraqitur këtë risi para disa javësh, drejtuesja e Sportelit Emilia Zarilli, dha edhe alarmin se një numër i madh autorizimesh të përgatitura (plot 320), nuk qenë tërhequr. "Janë më se 5% - saktësoi ajo - kanë një vlefshmëri prej gjashtë muajsh, dhe pasi kanë skaduar është shumë e vështirë hapja e praktikës".

Por si është e mundur që ata që kanë paraqitur kërkesë për bashkim familjar apo të flukse të mos tërheqin autorizimin? "Në të vërtetë në shumicën e rasteve këta njerëz nuk e dinë se autorizimi është gati. Atëherë është mirë që gjendja e kërkesës të kontrollohet në faqen e internetit (<http://domanda.nullalastalavoro.interno.it/>), dhe nëse shkruhet "Nulla osta consegnabile" (autorizim i dorëzueshëm), të shtypet faqja. Me atë fletë mund të paraqiteni pranë sportelit unik dhe të tërhiqni autorizimin edhe pse nuk ju ka mbërritur thirrja në shtëpi.

Sporteli Unik për imigracionin i Romës (www.prefettura.it/roma) ka botuar listën e personave që kanë bërë kërkesë për bashkim familjar por që nuk është arritur të kontaktohen. Në të vihen re edhe emra shqiptarësh si Abazaj, Balliu, Çarçani, Dervishaj, Frroku, Gjoka, Markgjonaj, Selmani etj. Kjo listë vlen si thirrje e fundit, kërkesat e atyre që nuk të paraqiten pranë Sportelit Unik do të refuzohen.

Hapja e pasdites së Sportelit unik, do të bëjë të mundur që të shmangen ngjarjet shqetësuese, për të cilat kanë shkruar gazetatat, për nëpunës të cilët kanë kërkuar para për të dhënë informacione. Zarilli këshillon që të denoncohen ata që bëjnë propozime të tilla "meqenëse ligji duhet respektuar dhe nuk duhet anashkaluar".

Ndërkohë në maj të 2009, Sporteli Unik ishte duke u marrë akoma me flukset e 2007-ës. Bllokimi thotë zv. prefekti, vjen nga kuestura, ku për shkak të një problemi me softuerin nuk arrihet të përmbillen praktikatat që duhen nisur. "Për sa i përket ritmeve tona - ka siguruar Zarilli - mund të japim autorizime apo të përtërijmë leje qëndrimi brenda javës, nëse Kuestura na jep aprovimin".



shqiptari

italiese.com

portali i komunitetit shqiptar në Itali

TANI EDHE ONLINE

Deklarata e të ardhurave është një dokument me të cilin Shteti mëson shumën e të ardhurave të përfituara gjatë vitit dhe vendos shumën e taksave të mundshme që individi duhet të paguajë.

Deklarata e të ardhurave mund të paraqitet nga të gjithë ata që kanë pasur të ardhura vitin paraardhës; ndërsa janë të detyruar të paraqesin deklaratën e të ardhurave të gjithë punonjësit e pavarur me "partita IVA" dhe sipërmarrësit, edhe nëse nuk kanë përfituar të ardhura.

Çdo vit Agjencia e të Ardhurave jep modelet që duhen përdorur për deklaratën e të ardhurave, që janë të ndryshëm sipër personat fizikë dhe shoqëritë; më të përhapurit janë Modello 730 dhe Modello Unico.

CUD

CUD (Certificazione Unica dei Redditi) është dokument që u lëshohet çdo vit punonjësve të varur, atyre që përfitojnë të ardhura të ngjashme me ato të punës së varur (p.sh. punonjësve bashkëpunëtorë për projekt) dhe pensionistëve.

Bashkëpunëtorët familjarë, edhe pse nuk marrin dokumentin busta-paga, fletë-rrogën, (buletinet INPS dëshmojnë pagesën e punonjësit dhe kontributet e derdhura), kanë të drejtën t'ia kërkojnë punëdhënësit CUD-in.

Në CUD shkruhen: të ardhurat e vitit pararendës; mbajtjet nga rroga që punëdhënësi ia ka paguar ndërkohë shtetit (ritenute), zbritjet fiskale për familjarët në ngarkim; shuma e kontributeve shoqërore të derdhura apo që u duhen derdhur enteëve të sigurimeve shoqërore.

CUD-i përmban shumat e përfituara çdo vit, si rrogë apo si pension, nga subjektet e sipërpërmendur, dhe është i domosdoshëm për të përpiluar më pas deklaratën e të ardhurave.

Kujdes, kush merr CUD-in nuk ka për detyrim të përpilojë deklaratën e të ardhurave nëse ka përfituar të ardhura vetëm nga punë e varur, e ngjashme me të (bashkëpunëtorët për projekt) ose nga pension.

MODELLO 730

Modeli 730 mund të paraqitet nga punonjësit e varur dhe nga pensionistët; në veçanti u leverdis ta paraqesin ata që kanë familjarë në ngarkim, edhe nëse nuk janë rezidentë në Itali.

Modeli 730 është i thjeshtë për t'u përpiluar dhe nuk ka nevojë për përllogaritje.

Personat që, gjatë vitit pararendës, kanë derdhur më shumë nga ç'duhet në arkat e shtetit kanë të drejtë të rimburohen, dhe shuma do t'u kthehet në rrogë apo në pensionin mujor. Kush ka paguar më pak nga ç'duhet, shuma tjetër do t'u mbahet drejtpërdrejt nga rroga apo pensioni.

Cilat të ardhura deklarohen
Modeli 730 mund të përdoret për të deklaruar: të ardhurat nga punë e varur; të ardhurat nga punë e ngjashme me të varurën; të ardhurat nga terrenet dhe ndërtesat; të ardhurat nga kapitali; të ardhurat nga puna e pavarur për të cilat nuk kërkohet "partita IVA"; disa nga të ardhura që i nënshtrohen tatimit të ndarë (tassazione separate).

DEKLARATA E TË ARDHURAVE

CUD, MODELLO UNICO E 730

Deklarata e të ardhurave mund të paraqitet nga të gjithë ata që kanë pasur të ardhura vitin paraardhës; ndërsa janë të detyruar të paraqesin deklaratën e të ardhurave të gjithë punonjësit e pavarur me "partita IVA" dhe sipërmarrësit, edhe nëse nuk kanë përfutur të ardhura.

Çdo vit Agjencia e të Ardhurave jep modelet që duhen përdorur për deklaratën e të ardhurave, që janë të ndryshëm sipër personat fizikë dhe shoqëritë; më të përhapurit janë Modello 730 dhe Modello Unico.

Skadencia

Më 30 prill ka përfunduar afati i paraqitjes së modelit 730 punëdhënësit apo entit që jep pensionin. Ndërsa tani ka kohë deri më 1 qershor, që modeli 730 të paraqitet vetëm pranë Qendrave të asistencës fiskale (që ndihmojnë edhe për përpilimin e modelit) për punonjësit e varur, CAF, ose pranë profesionistëve si konsulentët e punës dhe ekonomistët.

MODELLO UNICO

Modeli Unik është një dokument me të cilin mund të paraqiten disa deklarata fiskale dhe mund të përdoret nga: personat që nuk kanë CUD dhe që nuk mund të paraqesin modelin 730; personat që kanë kryer gjatë vitit pararendës disa punë (kanë punuar njëkohësisht për disa punëdhënës apo disa muaj për një ndërmarrje e disa muaj për një tjetër); personat fizikë që gjatë vitit pararendës kanë pasur të ardhura të ndryshme si, për shembull, të ardhura nga terrene, nga ndërtesa, nga kapitale, punë e varur apo e pavarur, pension; kontribuentët që duhet të paraqesin të paktën dy nga tatimet e mëposhtme: tatim mbi të ardhurat, IRAP, IVA.

Cilat dokumente duhen paraqitur

Dokumentet e nevojshme për për Modelin Unik janë: deklarata e të ardhurave; të dhënat personale dhe kodet fiskale të familjarëve në ngarkim; CUD-i i vitit pararendës; dokumente të ndryshme që dëshmojnë për shpenzime që mund të ulin detyrimet ndaj shtetit, si për shembull, shpenzime mjekësore, abonim të transportit publik; interesat e kredisë së shtëpisë.

Skadencia

Afatet për paraqitjen e Modelit Unik janë: brenda 30 shtatorit 2009 nëse deklarata paraqitet telematikisht, drejtpërdrejt nga kontribuenti apo nga një ndërmjetësues i autorizuar nga Agjencia e të Ardhurave; nga 2 maji deri më 30 qershor nëse deklarata paraqitet në letër përmes zyrave të postave apo të bankave (rrugë që mund të ndiqet vetëm nga ata që nuk kanë 'partita IVA')

Rosanna Caggiano
www.stranieriinitalia.it

**Kush mund të përdorë Modello 730**

Modelin 730/2009 mund të përdoret nga këta kontribuentët: pensionistë ose punonjës të varur; subjektet që gjatë vitit të mëparshëm kanë marrë kompensim zëvendësues të rrogës si për shembull "kompensim papunësie" (un'indennità di disoccupazione); ortakët e kooperativave; famulltarët e Kishës Katolike; gjykatës, parlamentarë dhe titullarë të zgjedhur postesh publike; subjekte të impenjuar në veprimtari shoqërisht të dobishme; bujqit që nuk janë të detyruar të paraqesin Modello 770, IRAP dhe IVA.

Cilat dokumente duhen paraqitur

Dokumentet e nevojshme për deklaratën e të ardhurave janë: deklarata e fundit e paraqitur një vit më parë; CUD (Certificazione Unica dei Redditi); fatura të ndryshme që dëshmojnë për shpenzime që mund të ulin detyrimet ndaj shtetit, si për shembull, shpenzime mjekësore, abonim të transportit publik; interesat e kredisë së shtëpisë; të dhënat personale dhe kodet fiskale të familjarëve në ngarkim; certifikatat e pronësisë së patundshme nëse ka të tilla dhe fatura që kanë të bëjnë me shpenzime për rristurimin e shtëpisë.



Kushtetuta italiane u njeh punonjësve të varur të drejtën për një periudhë pushimi të paguar, në mënyrë që të çlodhen dhe të rifitojnë energjitë psiko-fizike të konsumuara gjatë periudhës së punës.

Nga e drejta për leje të zakonshme nuk mund të hiqet dorë: çdo marrëveshje ndërmjet punëdhënësit dhe punëtorit që parashikon një gjë të tillë është e pavlefshme. I vetmi përjashtim nga ky rregull parashikohet për drejtorët që vullnetarisht mund të mos pranojnë të shkojnë me leje.

Dispozitat ne fuqi parashikojnë veçanërisht:

- të drejtën e punëtorit për një periudhë prej të paktën katër javësh leje të zakonshme në vit;

- të drejtën për të marrë të paktën dy javë leje gjatë vitit të maturimit (kjo periudhë duhet të jetë e vazhdueshme nëse e kërkon punëtori);

- e drejtën për të përdorur periudhën që mbetet në 18 muajt vijues pas mbarimit të vitit gjatë (maturazione);

- aplikimin e një sanksioni administrativ për dhunimin të këtyre detyrimeve (që shkon nga 130 euro deri 780 për çdo punëtor);

- ndalimin e zëvendësimit në para të katër javëve leje të garantuar, me përjashtim të rastit kur ndërpritet përfundimisht marrëdhënia e punës.

Kontratat kolektive të kategorisë përcaktojnë kohëzgjatjen minimale të lejes në varësi të periudhës efektive të punës së kryer. Edhe periudhat e marrjes në provë janë të vlefshme si kohë pune për përllogaritjen e lejes.

Nëse marrëdhënia e punës zgjat prej më pak se një vit, punonjësi ka të drejtë të marrë një të dymbëdhjetën e lejes vjetore për çdo muaj punë (konsiderohet muaj i plotë edhe periudha prej 15 ditësh). Kontratat kolektive të kategorisë mund të parashikojnë edhe kohëzgjatje më të madhe të lejes.

Në përgjithësi, punëdhënësi, në përputhje me nevojat e ndërmarrjes dhe të punonjësit, përcakton periudhën e kur mund të merret periudha e mbledhur e lejes; por parashikohet edhe mundësia që palët të bien dakord ndryshe.

Leja e zakonshme duhet të merret gjatë vitit e nuk mund të ndahet në më shumë se dy periudha. Punonjësi që nuk gëzon të gjithë lejen, mund të marrë ditët e mbetura të saj në një datë tjetër të vendosur në mirëkuptim me punëdhënësin vetëm në raste të

E DREJTA PER PUSHIME

Vera erdhi dhe të gjithë fillojmë të organizojmë pushimet, duke vendosur se ku do të kalojmë lejen e zakonshme, periudhën e shkëputjes nga puna që ligji u njeh punonjësve

veçanta e të parashikuara shprehimisht nga ligji, leja e zakonshme mund të rimbursohet në para. Kështu, për shembull, në rast kur marrëdhënia e punës përfundon, punëdhënësi është i detyruar të paguajë punonjësën për të gjitha ditët e lejes që i takojnë por që nuk ka marrë.

Leja pezullohet automatikisht gjatë ditëve të festave dhe në periudha sëmundjeje apo fatkeqësie; pasi përfundojnë këto rifillon numërimi i ditëve të lejes së përcaktuar.

Gjatë mungesës në punë për leje, punonjësi ka të drejtë për të njëjtin trajtim ekonomik si të ishte duke punuar. Gjatë periudhës së lejes punëdhënësi është i detyruar, jo vetëm të paguajë punonjësën por edhe të derdhë të gjitha kontributet për të si zakonisht.

Ndërprerja e marrëdhënies së punës

Në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës (vetëm në rast se punonjësi nuk mund të marrë lejen përpara përfundimit të marrëdhënies së punës), punonjësit i duhet dhënë shumë në para zëvendësuese për pushimet që i takojnë e nuk ka arritur të marrë. Kjo shumë është e barabartë me rrogën që do të merrte për çdo ditë lejeje. Edhe në rast se ndërprerja e marrëdhënies bëhet gjatë vitit, punonjësit i takojnë si pushime aq të dymbëdhjeta të lejes sa janë muajt që ka punuar gjatë vitit.

Leja për colf dhe badante

Edhe punëtorët shtëpiakë kanë të drejtë të gëzojnë leje të zakonshme. Kohëzgjatja minimale e lejes përcaktohet nga kontrata kombëtare kolektive që parashikon, pavarësisht nga kohëzgjatja e orarit të punë, për çdo



Kontratat kolektive të kategorisë përcaktojnë kohëzgjatjen minimale të lejes në varësi të periudhës efektive të punës së kryer. Edhe periudhat e marrjes në provë janë të vlefshme si kohë pune për përllogaritjen e lejes.

vit pune pranë të njëjtit punëdhënësi 26 ditë pushime. Në rast se marrëdhënia e punës ndërpritet gjatë vitit, edhe bashkëpunëtorit shtëpiak i takojnë si pushime aq të dymbëdhjeta të lejes sa janë muajt që ka punuar.

Punonjësit e huaj mund t'i mbledhin lejet gjatë dy vjetëve me pëlqimin e punëdhënësit, në mënyrë që të kenë një periudhë më të gjatë për tu kthyer në vendin e vet, pra mund të mos i marrin një vit e t'i mbledhin ditët me ato të vitit pasardhës për një periudhë maksimale prej 52 ditësh të njëpasnjëshme pushimi.

Leja dhe sëmundjet

Sëmundja gjatë lejes së zakonshme duhet të komunikohet menjëherë nga punëtori në ndërmarrje me dërgimin e një certifikate mjekësore. Është e rëndësishme që me lajmërimin punëtori të përcjellë edhe banimin e tij për të lejuar në oraret e caktuara (nga ora 10 deri në 12 dhe nga 17 deri në 19 të gjitha ditët e javës) kontrollin nga ana e mjekut të ngarkuar nga Inps-i dhe nga Asl-i.

Sëmundja pezullon lejen vetëm nëse prek rikuperimin e energjive psiko-fizike të punëtorit ndërsa punëdhënësi ka të drejtë të provojë se nuk është kështu (dhe që leja nuk duhet të ndërpritet).

Për shembull, në rast se punonjësi shtrohet në spital gjatë lejes, kjo dëshmon që, në ato kushte, nuk mund të vazhdojë pushimet, ndaj leja e zakonshme ndërpritet. Por nëse punonjësi ka dhimbje koke, leja nuk ndërpritet, përkundrazi ditët e pushimit e ndihmojnë punonjësën të shërohet.

Me një fjalë, sëmundja e shfaqur gjatë lejes, nuk e ndërpret atë automatikisht dhe është e nevojshme të vlerësohet çdo rast i veçantë nëse është vërtetë i pamundur gëzimi i çlodhjes gjatë lejes.

Mosmarrëveshjet me punëdhënësit

Periudha e lejes së zakonshme përcaktohet nga punëdhënësi dhe i komunikohet punonjësit. Nëse punonjësi merr lejen pa pëlqimin e punëdhënësit apo në rast se vonon kthimin në punë pas pushimeve pa asnjë justifikim, mund të ndëshkohet me sanksione disiplinore, dhe në raste të rënda edhe me pushim nga puna.

Punonjësi që refuzon pa asnjë motiv çdo ofertë të punëdhënësit lidhur me periudhën e lejes së zakonshme, humbet çdo të drejtë qoftë për kompensim për leje të pamarrë qoftë për leje shtesë.

Kontrata e bashkëpunimit për projekt

Bashkëpunëtorët për projekt nuk gëzojnë të drejtën e lejes së zakonshme. Këto kontrata nuk parashikojnë mbledhjen e ditëve të pushimeve (maturazione di ferie), pasi leja e zakonshme është e drejtë që u njihet vetëm punonjësve të varur e jo atyre autonomë.

Rosanna Caggiano
www.stranieriinitalia.it


FLET NË BOTË ME PAK



WIND

NËSE KE CELULAR ME SKEDË RIMBUSHËSE, ME 5 EURO NË MUAJ MUND TË TELEFONOSH NË ITALI NGA JASHTË SAJ DHE TË MARRËSH TELEFONATA ME VETËM 15 QINDARKA NË MINUTË, PAS MINUTËS SË PARË TË BISEDËS. PËR TË AKTIVIZUAR **EASY ROAMING** DËRGO NJË SMS NË NUMRIN FALAS 4033 ME TEKSTIN EASY ROAMING SI

PËR INFORMACIONE WWW.WIND.IT



SIPERMARRES SHQIPTARE

Një drekë në Pomezia në restorantin e Erletit

Në qendër të Pomezia-s ndodhet një restorant me emrin "La Bocca della verità". "Këtë emër gjetëm dhe këtë lamë"- na thotë Erleti, me kombësi shqiptare, cili është menaxheri dhe kuzhinieri i restorantit.

Erlet Mehmeti jeton në Itali që prej 20 vjetësh. "Prindërit i kam të dy nga qytete bregdetare të Shqipërisë, babai nga Saranda dhe nëna nga Vlora, ndërsa unë kam lindur dhe jam rritur në Tiranë. Në Shqipëri përfundova shkollën e mesme dhe në moshën 20 vjeçare erdha në Itali. Dihet që fillimi është gjithmonë i vështirë. Jam martuar me një zonjë polake dhe kam një vajzë 7 vjeçe të cilën e kemi quajtur Elenoire. Në Shqipëri dihet që në atë sistem jemi rritur si ateist. Ashtu e kërkonte koha, por dua t'ju them se që nga momenti që u bëra prind unë u bëra edhe besimtar. Besoj në një zot Universal, në një zot për të gjithë, dëshiroj dhe përpiqem të bëj vetëm mirë.



Punët që kam bërë në fillim këtu ishin të çfarëdollojshme, mjaft që të ishin punë të ndershme, por pak nga pak fillova të dashurohem me profesionin e kuzhinierit, ose më mirë të them me kuzhinën italiane. Vazhdova shkollën për kuzhinier dhe tashmë jam shef. Punoj bashkë me vëllain tim Genin për administrimin e këtij restoranti. Në këtë restorant kemi vetëm 6 muaj. Ai ka një kapacitet prej 80 vendesh. Më parë administronim një restorant buzë detit. Klientët që kishim atje na ndjekin edhe këtu, sepse dimë të kënaqim shijet e tyre... Kemi punësuar qytetarë italiane me të cilët kemi marrëdhënie të mira jo vetëm pune, por edhe miqësie. Lënda e parë, peshku, është i freskët, me furnizim ditor mund të shikohet nga klientët në kasetat e ekspozuara në hyrje të lokalit".

Recetat që përgatit Erleti janë të shijshme dhe të shumëllojshme. E pyesim se çfarë kuzhine gatuan? Përgjigjet: "Vetëm kuzhinë italiane me bazë peshku dhe mishi."

Pikërisht në këtë restorant një çift shqiptar feston përvjetorin e martesës. Të ftuarit italiane, kuzhina italiane, kuzhinieri shqiptar. Një atmosferë e vërtetë feste dykombëshe. Edhe ky episod flet për integrim.

Elira Maksuti, Romë

Gianni Pennacchi, il Giornale

Ke të dashur? "Jooo, është akoma shpejt, jam mirë me mamin dhe me babin", qesh ajo me gëzim. Zëri është pak i Kashpër dhe grykor, monokord. Më duke sikur flas me time bijë, më të madhen, dhe prekem pak. Edhe sepse kurrë nuk mendoja se do të mësonte të fliste, besoja se do të ngelej në gjuhën e falangjeve. Vetëm buzëqeshja ka mbetur e njëjtë si para 11 vjetësh, në kampin që shqiptarët kishin ngritur në restorantin e Campingut Orsa Maggiore, ku lëkundej duke ngritur lart dy sy të shuar. Ishte një fëmijë jashtëzakonisht i bukur, një engjëll biond që fati i keq e bëri shurdhe, dhe për pasojë edhe memece, të verbër dhe sakate për faj të një deformimi të trashëguar në legen.

Sot është një vajzë e bukur 17-vjeçare, flet më në fund pas shumë vitesh logopedie, mban syza me lente të trasha, që rikuperojnë në maksimum shikimin, dhe çalon nga pak. Për një vit kur pranë Rizzolit të Bolonjës do t'i bëjnë operacionin e tretë, do të ecë si çdo vajzë tjetër e moshës së saj. Kjo është mrekullia e Mirsadës, të cilën e kishin fshehur prindërit poshtë dyshekëve të kampingut të Cassano Murge, kur ministri i brendshëm i atëhershëm, Giorgio Napolitano dha urdhër të riadhesoheshin 544 shqiptarët, nëpërmjet një operacioni blic të shpejtë dhe të padhembshëm (sa për të thënë) mëngjesin e 3 prillit 1997.

I ati u hip në një autobus për t'u imbarkuar në Brindisi ndër të parët, ndërsa nga dritarja hodhi një grumbull letrash e dokumentesh që flitnin për ferrin e tij dhe të Mirsadës. "Tu giornalista buono, tu conosce, pensa tu a mia figlia!" u lut Halit Rexha. Por vogëlushja kur, mbaroi shpërngulja e kampit, filloi të qante. E zbuluan, dhe një polic me lot në sy, e mori dhe e vendosi në makinën e fundit që po nisej. Qe dënuar të kthehej në ferr, në një vend ku nuk njihet gjuha e falangjeve, e jo më komunikimi me prekjen e tyre.

Zgjidhjen e gjetëm në gazetarët, që lëvizëm çdo gur në botën e informacionit dhe spektaklit dhe arritëm të kthenim Mirasadën dhe familjen e saj pas tre muajsh. Ministri i jashtëm e priti me ceremoni, jo ai i brendshmi. Lega del Filo d'Oro, e priti në Osimo, të atit i gjetën punë, në Rizzolin e Bolonjës e operuan dy herë, pas operacionit të tretë vitin tjetër këmba e dëmtuar do të jetë në gjendje të përkryer. "Rikuperuam çdo mangësi që kishte, tani shkon në shkollën publike normale" tregon e kënaqur Patrizia Ceccarani e Legës. Pas shumë vitesh logopedie

dhe kërkimi të çfarëdolloj kure të mundshme, "Duhet të shkoj tek okulisti në 21 maj", thotë Mirsada. Flet shumë mirë, i them. "Faleminderit" përgjigjet. Po, shikon mirë? "Shumë mirë". E ëma, Viola, buzëqesh: "Kur del nuk do të vërë syzet, vendos lentet. Edhe pse ngandonjëherë përplasat pas gjërave". Këto ditë i ati nuk është në shtëpi, është në Shqipëri. "Ne kthehem në Shkodër çdo vit, në gusht" tregon Mirsada. Ajo është në vit të tretë të shkollës së mesme profesionale (ragioneria), "kur të rritem dua të jem nëpunëse në ndonjë ndërmarrje, por varet nga ajo që do të më ofrojnë ... të shohim".

Familja Rexha duket një familje e lumtur, vëllezërit Jas-

Il festival delle culture di Ravenna apre il sipario con una miriade di eventi. E festeggia anche i 10 anni di "Bota shqiptare", il più longevo periodico per gli stranieri in Italia

MREKULLIA E MIRSADES

Sot është një vajzë e bukur 17-vjeçare, flet më në fund pas shumë vitesh logopedie, mban syza me lente të trasha, që rikuperojnë në maksimum shikimin, dhe çalon nga pak. Për një vit kur pranë Rizzolit të Bolonjës do t'i bëjnë operacionin e tretë, do të ecë si çdo vajzë tjetër e moshës së saj.

mina 14 vjeçe dhe Samuelli 10 vjeç, vështrojnë dhe dëgjojnë me kuriozitet. Shtëpia është e vogël por me dinjitet, "na e dha komuna para pesë vjetësh" thotë Viola, "por do të na duhej një dhomë më tepër". Edhe ajo punon, pastron shtëpi, dhe asiston një të moshuar. Haliti tani ka dalë privat, me një ortak drejton një aktivitet të vogël riciklimi të materialeve të hekurit. Në lagje dhe në gjithë Osimon, Rexhat i duan dhe i respektojnë, "nëse njeriu punon dhe sillet mirë të respektojnë - thotë e ëma - ne patëm fat".

Mirsadës i bie celulari me vrim, ajo përgjigjet menjëherë. Aparat akustik i teknologjisë së avancuar. "Janë Valentina dhe Claudia, shoqet e mia të ngushta që kam njohur në nëntë-vjeçare". I kujtohen ato ditë? "Jo

dhe aq, sepse isha e vogël. Ndonjëherë e mendoj, dhe më vjen për të qarë". Mirsada cila është ëndrra jote? "Dua të kthehem në Romë. Kam qenë vetëm një herë, kur erdhëm tek gazeta jote pas një viti, të kujtohet?" Si nuk më kujtohet? Dhe që atëherë askush nuk ka ardhur të të vizitojë më? "Kur më operuan herën e parë erdhi Luca Zingaretti, herën e dytë erdhi Sabrina Ferilli. U gëzova pa masë. Por tani dua të kthehem në Romë për të takuar të gjithë ata që më kanë ndihmuar, edhe Renzo Arboren që nuk e shoh prej vitesh" Po nga qeveria, nga politikanët, nuk është bërë gjallë asnjë? "Jo nuk kam takuar asnjë, që atëherë". Ndoshta presidenti Napolitano mund t'i çonte një ledhatim Mirsadës.



Lart Mirsada sot dhe poshtë në foto me prindërit para dymbëdhjetë vjetësh kur mbërriti klandestine në Itali



Dal 30 maggio al 7 giugno si terrà a Ravenna il Festival delle Culture: 9 giorni di musica, incontri, mostre, danze, cibi, seminari, mercati, burattini, cinema, teatro e quant'altro possa fare della vita l'arte dell'incontro.

La manifestazione affonda le sue radici nei Festival "L'Essenza delle Presenze" e "MeditaEuropa" ed è promossa dal Comune di Ravenna, Regione Emilia Romagna, Rappresentanza dei cittadini stranieri di Ravenna, Associazione Meditaeuropa.

Circa 90 le associazioni di migranti e di italiani coinvolte, 12 i concerti in programma, 10 spettacoli di danze tradizionali, 4 convegni per un festival unico, il primo in Italia con un direttore artistico di origine straniera, lo scrittore Tahar Lamri.

Il clou del Festival sarà all'Almagià nelle serate del 5, 6, 7 giugno. Il venerdì 5 alle ore 19.30 la Banda cittadina di Ravenna partirà da Piazza del Popolo marciando attraverso le "Porte etniche" dell'artista Giampaolo Masotti fino all'Almagià, dove verrà accolta dalla capoeira del gruppo Conquinho Baiano e dai burattini di Arrivano dal Mare. Durante la serata spazio alle seconde generazioni di immigrati con il rapper ravennate di origine angolana Nashy che ospiterà, in un contest, coetanei da varie parti di Italia, in particolare Inoki e i Mic Meskine. In concerto anche il gruppo italo-marocchino-argentino Les Hardonik che saranno introdotti dalle giovani promesse ravennate dei The Slide.

Ospite d'onore delle tre giornate l'Albania con artisti del calibro di Lili Cingu, Rexhep Celiku, figure leggendarie del ballo tradizionale albanese, il celebre attore Mirush Kabashi e la cantante Fatime Ymeri (sul palco sabato 6 giugno). In esclusiva il complesso Spartiti per Scutari Orkestra, nato da un incontro fra il maestro albanese Bardh Jakova e la scuola di musica popolare di Forlimpopoli (sempre sabato 6). Poi la mostra "Scritti di luce" (100 anni di Albania in foto 1850-1950 - Marubi) e gastronomia dal Paese delle Aquile. Sempre sabato 6 giugno la manifestazione festeggerà i dieci anni di pubblicazione di "Bota shqiptare" con la presenza di giornalisti di "Bota shqiptare" e "Shqiptari i Italisë".



MOS I VËR KUFIJ ZËRIT TËND.

Mjaftojnë 10 qindarka për t'u ndier në shtëpi.

Aktivizo Call Your Country: flet me Shqipërinë duke filluar nga 10 qindarka në minutë. Madje, me Noi Wind, me vetëm 6 euro në muaj mund të flasësh falas me të gjithë celularët Wind për 200 minuta në muaj.

Aktivizim falas për të gjithë klientët e rinj deri më 26 korrik 2009

Call Your Country ka kosto gjashtëmujore prej 4 eurosh. Tarifa drejt celularëve është 10 qindarka në minutë. Impulsi i përgjigjes 15 qindarka. Tarifimi çdo 60 sekonda. Për informacione www.wind.it



WIND



ERMAL META

dhe "la fame di camilla"

Nga periferitë e artit të pavarur këtë qershor do të nxjerrë kryet një bandë emri i së cilës do të dëgjohehet shumë larg. Kanë një emër të çuditshëm, të thellë e alternativ. Sepse alternativë, të thellë e të shumë-interpretueshëm janë edhe anëtarët e saj. Mjafton të përmendet se njëri prej tyre është shqiptar, e madje se një nga këngët e albumit të parë këndohet në shqip, ndërsa këngë të tjera bartin momente të dhimbshme Shqipërie brenda, dhe se ende pa dalë në treg pikërisht shqiptaria e këngëve dhe e solistit goditën pozitivisht publikun italian edhe pse të pamësuar: "Ja ku po del Italia

multietnike" do të thoshin ithtarët e alternativizmit. Por nga ajo që perceptohet nga kitarat mediuete, tekstet tmerrsisht poetike, përcjellja e emocioneve, vjen vetiu bindja se bëhet fjalë për një grup të rinjsh që do të shkojnë larg, të mbrujtur me më të mirën frymë të rrokut britanik, e ndërkombëtar, që të bën të harrosh qytetin e kontekstin nga vijnë. E gjithë kjo lindi nga takimi i shqiptarit Ermal Meta, dhe barezëve Lele, Dino e Johni.

Më i përmenduri ndër pjesëtarët e grupit është pikërisht Ermali, jo vetëm sepse nuk ndeshet përditë një shqiptar që luan muzikë rrok në një grup italian

Nga periferitë e artit të pavarur italian këtë qershor do të nxjerrë kryet një bandë emri i së cilës kritikët bëjnë bé se do do t'i dëgjohehet shumë larg. Kanë një emër të çuditshëm, "La Fame di Camilla". Dhe një kokë kryesore, shqiptarin Ermal Meta. I cili nuk ngurron të përfshijë në albumin e saponxjerrë nga Universal edhe një këngë në shqip.

me perspektivë tejte të suksesshme por sepse Ermali është disi pika kyçe e grupit që i jep atij zërin e solistit, ku ndodhet në mënyrë irracionale ngjyra shqiptare, dhe tekstet aq poetike të këngëve që madje dikush i ka përkufizuar pothuaj kantautoriale. Nuk është e lehtë të bësh muzikë, italiane, larg banalitetëve të shqetësimeve boshe prej adoleshentësh me depression. Dhe duke dëgjuar këngët dhe kitarën mediuete të grupit, të duket se dëgjon Coldplay, apo Radiohead të cilët çuditërisht paskan ndryshuar gjuhë, në shqip apo në italisht. E gjithë

ERMAL META dhe "la fame di camilla"

vijon nga faqja 13

kjo fshihet pas emrit të Ermal Metës, i cili jep i grupit poezinë e këngëve dhe muzikalitetin e kitarës së ndjeshme.

Ermali është një shqiptaro-italian nga ata të brezit të dytë multietnik. Ka mbërritur në Itali në '94-ën e largët dhe ka bërë të vetin qytetin e Barit, ku ka lindur edhe "La fame di Camilla". Por muzikën e ka marrë me vete nga ana tjetër e Adriatikut ku e ka studiuar seriozisht në qytetin e tij të lindjes në Fier, në shkollën e muzikës "Jakov Xoxa", e cila shquhet për mbledhje talentesh nga gjithë Shqipëria e jugut. Por për një rocker të ardhshëm i cili nuk synon të kufizohet vetëm me interpretimin e klasikëve sado virtuoze të tingëllojë kjo gjë, vitet e shkollës kanë lënë një hije të hidhur prej vendi të zymtë skolasik, ku artistët privohen nga krijimtaria e artit. Dhe krijimtaria është "një dhuratë" - thotë diku Ermali - e cila nëse e ke, qëndron aty e fjetur dhe pas pak formësohet në diçka të re, që duhet vetëm nxjerrë nga vetja ashtu siç vjen. Për këtë "La fame di Camilla", e lë veten në dorë të lirisë së shprehjes së emocioneve që burojnë vetiu. Ato janë të shumta dhe nuk fillojnë e as mbarojnë vetëm me dashurinë, e humbur, të mohuar, apo të mbaruar siç ndodh rëndom në botën e muzikës sot. Por fillojnë që nga ndjesia e hollë e të kaluarës dhe gjërave të humbura, e shkojnë deri tek dhimbja universale e tragjedisë e shqiptarëve të humbur në marsin e largët të '97-ës në kanalën e Otrantos. E gjitha kjo e shprehur me një figuracion dhe një stilistikë poetike të bartur instinktivisht nga kultura ballkanase prej nga vjen solisti e njëkohësisht pena e grupit. Shumë para daljes së diskut në treg "La fame di Camilla" është ndjekur besnikërisht koncerteve dhe është klikuar e komentuar bujarisht në internet. Ndërsa Ermal Meta ka qenë i njohur për publikun italian që në kohën e grupit Ameba4 me të cilët



ka kënduar edhe në skenën e Sanremos në vitin 2006. Disku i ri nxirret në treg nga shtëpia diskografike prestigjioze Universal, ndërsa disa prej këngëve prej disa javësh tashmë transmetohen nga radiot italiane me shumë entuziazëm. "Më e pëlqyera - thotë Ermali - është kënga në shqip "Në dorën tënde"" që i paraqet publikut italian për herë të parë gjuhën shqipe, me muzikalitetin e saj të theksuar - siç e ka përkufizuar një ndër kritikët që kanë shkruar për "La fame di Camilla".

Ndërsa muzika italiane vazhdon të ndiqet në Shqipëri, edhe pas degradimit të përgjithshëm të saj në popin adoleshencial, ky grup ka për të tërhequr jo pak, e për t'u bërë padyshim një protagonist hitesh. Nuk do të duhet shumë kohë për t'i parë me kitarë e bateri në dorë përpara publikut shqiptar, i cili këtë herë do të ketë të bëjë me një grup italian, një këngëtar shqiptar, e një rrok cilësor që rrallë herë është dëgjuar në këtë anë të botës. ma.ru.

INTERVISTA

nga Marjola Rukaj

Shqiptari i Italisë: Si lindi ideja për te krijuar këtë grup?

Ermal Meta: Këtë ide e kam pasur gjithmonë brenda besoj, por si çdo gjë e rëndësishme duhet pak kohë për ta pjekur, edhe kjo ide priti momentin e duhur i cili erdhi mbasi mbaroi marrëdhënia ime me grupin me të cilin luaja më parë, "Ameba4". Me këtë te fundit patëm edhe një kontratë diskografike, morëm pjesë edhe në Sanremo 2006, po nuk qe shkruar të ishte një lidhje e gjatë... nuk vajti mirë. Sidoqoftë jo çdo e keqe mbërrin për të keq!

Si u takuat me shokët e tjerë?

Shokët e tjerë i takova rastësisht, nuk i njihja po secili nga ne pa diçka tek të tjerët që na linte të kuptonim se bëhej fjalë për diçka që mund të funksiononte. Filluam shumë shpejt të provonim këngët që unë kompozova, disa nga të cilat janë në albumin që do të dalë në qershor. Rezultatet qenë të shpejta dhe me cilësi të lartë (po të marrim parasysh faktin se jemi vetëm në fillim). Pas dy muajsh që luanim bashkë filluam koncertet e para dhe që atëherë, që në shtator të 2007-ës, nuk u ndalua deri sa mbërritëm në studio regjistrimi për diskut e parë që përmenda më lart.

Cilat janë prirjet muzikore që grupi synon të paraqesë?

Grupi ynë, muzika jonë synon vetëm një gjë... ndershmëri artistike. Të tillë ka shumë pak në botën muzikore të sotshme.

Të komunikosh me publikun pa frikë, me të gjitha ndjenjat njerëzore... Dashuria është e rëndësishme, po nuk është e vetmja ndjenjë që meriton një këngë. Zgjedhim atmosfera dhe tinguj të fto-

La fame di Camilla nxirret në treg nga shtëpia diskografike prestigjioze Universal, ndërsa disa prej këngëve prej disa javësh tashmë transmetohen nga radiot italiane me shumë entuziazëm. "Më e pëlqyera - thotë Ermali - është kënga në shqip "Në dorën tënde"" që i paraqet publikut italian për herë të parë gjuhën shqipe, me muzikalitetin e saj të theksuar - siç e ka përkufizuar një ndër kritikët që kanë shkruar për "La fame di Camilla"

htë, tipike të Evropës së veriut, po janë atmosfera që "ngrohen" nga rezultati përfundimtar i këngës. Tekstet shkruhen me shumë kujdes, çdo fjalë ka kuptimin dhe dimensionin e vet.

Përse quhet kështu? E kujt është merita për këtë emër kaq të veçantë?


Nëse flisni për meritë, më duket se titulli është i pëlqyeshëm. Çfarë është uria, la fame?!

Diçka para së cilës çdo njeri përkulet në një farë mase. Feuerbach shkruante: "Njeriu është ajo çka ha"... Uria është instinkt. Instinktivisht ne bëjmë muzikë, dhe me muzikë ushqejmë gjithë organet tona përveç stomakut...

Përse një këngë e kënduar shqip? Nuk shkon kjo pak si kundër globalizimit dhe pushtimit të tregjeve ndërkombëtare?

Jo, përkundrazi! Në qoftë se globalizimi është afërsia sa më e madhe dhe shkëmbimi ekonomiko-kulturor midis Vendeve anë e mbanë Botës,

vijon në faqen 16



Ka qenë edhe është krenari për mua që jam shqiptar. Vështirësitë i kam pasur për arsye të tjera por nuk zgjatëm sepse kjo do të ishte përgjigja e një pyetjeje të pabërë! Për fat të mirë arti nuk ka nevojë për pasaporta. Ka shume veta që më pyesin se si është jeta në Shqipëri. Kjo lloj muzike mund të japë popullaritet, po të jetë kështu te qenët shqiptar do të më lejojë të flas për vendin tim me një publik më të madh, dhe të kem dikë më shumë për të më dëgjuar.

Fabrizio Galassi

La fame di Camilla, është grupi i panjohur më i famshëm në Itali. Emri i tyre qarkullon rreth e rrotull prej kohësh dhe përgëzimet për muzikën e tyre janë nga më të ngrohatat, madje po të ishim në Angli do të thuhej se LFDC janë the next big thing, por për fat të keq jemi në Italinë e vocërr të këngës së San Remos, dhe Camilla do të vazhdojë të vuajë nga uria. Singërisht shpresoj që fjalja e fundit të mbetet batutë, dhe që ndonjë etiketë apo jo etiketë të investojë qindarkat e fundit në diçka madhështore.

"Në dorën tënde" të kujton pa dyshim Radiohead me këngën "Kid A", kitarat janë plot emocion dhe melankoli, bateria luan e hapur duke zgjatur notat, ndërsa Ermal Meta këndon në shqip, një gjuhë e largët, të cilës nuk ia njohim historinë, edhe pse është vetëm pak kilometra larg brigjeve tona.

Në këtë këngë dëgjohet muzikaliteti i saj, i bërë edhe më melodik nga timbri i lehtë i Metës, që gërmon nota larg tokës së tij, larg madje edhe nga e jona, duke mbërritur madje në Islandë.

GRUPI I PANJOHUR MË I FAMSHËM NË ITALI

Për fat të keq, kënga është ndërprerë thatë nga ndonjë gabim i ngarkimit të serverit, dhe mbaron papritur dhe të bën të zgjohesh i trembur si fëmijët në mes të natës, dhe të fillosh të qaravitesh.

Ermali këndon edhe italisht, një lëvizje kjo e shkëlqyer nga pikëpamja

gjeografike, por profesionalisht e gabuar, gjuha e tij është diçka e re, pak a shumë si hopelandic e Birgisson-it, vetëm se ndryshe nga këngëtari i Sigur Ros, Meta nuk e ka shpikur, por duket sikur e ka zbuluar nga pikëpamja muzikore. Përtej gjuhës, zëri i LFDC, ka një peshë tim-

bri të jashtëzakonshme, të sigurt dhe të vendosur në notat e ulëta, që bëhet brilante dhe e plotë në momentin e falsitetit, duke dhënë një tonalitë unik që do bënte me turp saltot harmonike të Giuliano Sangiorgi-t, ndërsa Chris Martin-in do ta shtinte në mendime. Por jo gjithçka përqendrohet tek mikrofoni, edhe amplifikatorët shtojnë bukuri, veçanërisht nëse bëhet fjalë për këngë të ngadalta si "Në dorën tënde", apo instrumentalja "Ricordi tristi sott'acqua" dhe "Mostro". Kur BPM-të ngrihen të kujtojnë diçka pak origjinale, derivate, edhe pse të një cilësie të shkëlqyer; tepër Radiohead, tepër Coldplay (i jashtëzakonshëm në "Le voci del silenzio"), shumë Keane ("Globuli"). Ndoshta La fame di Camilla, e ka të qartë se ka në dorë një thesar të vogël, dhe do ta shndërron në valutë italiane, por kjo është një lëvizje pak ambicioze; duhet ta mbajnë të fshehtë dhe t'ia ofrojnë një publiku që e kupton vërtetë, të shkojnë jashtë shtetit (edhe në mënyrë virtuale), të këndojnë shqip, të këndojnë ngadalë, dhe të injorojnë tokën prej nga vijnë. Suksesi duhet edhe të shpërblejë, dhe Italia nuk është vendi i shpërblimeve.



vijon nga faqja 15

arti në këtë rast mund të luajë një rol të rëndësishëm! Nga ana tjetër nuk synojmë aspak që të luajmë këtë rol sepse as kemi këtë prirje dhe as nuk kemi, besoj, një forcë të tillë. Për ne, muzika, si i gjithë arti, është thjesht një shprehje e lirë e ndjenjave. Në diskun tonë është edhe një këngë e cila titullohet 28-03-1997... Bëhet fjalë për një datë shumë të hidhur për tokën shqiptare... Kjo këngë u kush-tohet të gjitha viktimave të asaj dite.

Si e shpjegoni që kjo këngë megjithëse shqip është pritur shumë mirë?

Sepse muzika nuk njeh kufij! Në këtë rast është krijuar një ekuilibër midis tingujve të këngës që janë modernë dhe një gjuhe e cila e kënduar në këtë mënyrë... me ngadalë, ndoshta ka një shije tjetër.

Përse keni preferuar ta nxirni këtë disk në Itali, edhe pse tregu italian për këtë lloj muzike nuk është absolutisht më i favorshmi në Evropë? Keni ambicie ndërkombëtare për më vonë?

Disku do të dalë në Itali sepse 11 këngë prej 12 këngëve që ai përmban janë italisht. Vërtet tregu italian për këtë lloj muzike është pak i vështirë sepse tradita muzikore italiane është shumë konservatore dhe muzika jonë ka nuanca evropiane, por besoj se do të gjejmë vendin tonë në panoramën muzikore italiane edhe pse ky i tanishmi është një çast pak i vështirë për diskografinë në nivel botëror. Për momentin do të përqendrohemi në Itali, ndërsa për Evropën do të mendojmë kur të jetë koha e duhur. Nuk e fsheh dhe kuptohet që një gjë e tillë do të na pëlqente shumë, por tani për tani duhet të krijojmë diçka në Itali e pse jo, në të ardhmen edhe në Shqipëri.

Si lindin këngët tuaja? Kush i shkruan tekstet, të cilat janë jashtëzakonisht të ndjeshme?

Të shpjegosh si lind një këngë është e vështirë por do

ERMAL META dhe "la fame di camilla"



të mendojem me pak fjalë t'ua tregoj. Unë zakonisht ndiej se diçka është duke më lëvriur nga brenda. Ndërsa ndihem kështu duhet të kem një instrument pranë, dhe të krijoj. Kështu ndodh që nuk jam kurrë me duar bosh. Me kitarë ose piano, nuk ka rëndësi, e vetmja gjë që ka rëndësi është të mund të luaj diçka. Kënga pastaj përpunohet bashkë me grupin por vetëm pasi unë kam shkruar tekstin. Po, tekstet i shkruaj unë.

Si keni hyrë në botën e muzikës?

Fillova të studioj piano në shkollën e muzikës në Fier, qytet në të cilin kam lindur dhe kam jetuar deri në moshën 13 vjeç. Mbas një viti që studioja, lashë mësimin e pianos për shkak të problemeve në shkollë, shumë rreptësi, pak fantazi... Erdha në Itali dhe pianon e kam filluar përsëri në moshën 19-vjeçare. Kësaj here pa marrë leksione... i bija pianos vetëm për kënaqësinë time personale dhe për të shkruar këngë. Më vonë, rreth moshës 21-22 vjeç, pësova një aksident që më detyroi të rrija vetëm ulur dhe për 3 muaj nuk pata mundësi

të luaja në piano. Një shok më solli kitarën e tij dhe ajo që filloi si lojë u shndërrua në diçka shumë të rëndësishme për mua: mundësia që të zbuloja një instrument tjetër me një botë tjetër. Në ato 3 muaj mund të kem shkruar gati 60 këngë, por prej tyre nuk mbaj mend më asnjë...

Studimet në Itali kanë qenë të këndshme. mbarova shkollën e mesme në liceun shkencor dhe fillova universitetin për gjuhë të huaja. Jam regjistruar në kursin me korrespondencë.

Më kanë mbetur vetëm 2 provime që shpresoj të jap sa më shpejt.

Kur jeni transferuar në Itali (Bari) dhe çfarë pritnit të gjenit aty?

Në Bari erdhëm në vitin 1994. Shpresonim të na priste diçka për të cilën kishim lënë Shqipërinë. Shumë shqiptarë e dinë mirë për çfarë e kam fjalën, është diçka që gjithsecili e bart brenda vetes dhe është diçka që do të shoqërojë të gjithë për shumë vite akoma. Shpresoj vetëm që brezat që do të vijnë të gjejnë çdo gjë në vendin e tyre.

Ka qenë i vështirë të qenët

Kënga në shqip është pritur mirë edhe nga italianët sepse muzika nuk njeh kufij! Në këtë rast është krijuar një ekuilibër midis tingujve të këngës që janë modernë dhe një gjuhe e cila e kënduar në këtë mënyrë... me ngadalë, ndoshta ka një shije tjetër

shqiptar? Ç'do të thotë sot të bësh këtë lloj muzike dhe të jesh shqiptar?

Ka qenë edhe është krenari për mua që jam shqiptar. Vështirësitë i kam pasur për arsye të tjera por nuk zgjatem sepse kjo do të ishte përgjigjja e një pyetjeje të pabërë! Për fat të mirë arti nuk ka nevojë për pasaporta. Ka shumë vetë që më pyesin se si është jeta në Shqipëri. Kjo lloj muzike mund të japë popullaritet. Po të jetë kështu, të qenët shqiptar do të më lejojë të flas për vendin tim me një publik më të madh, dhe të kem dikë më shumë për të më dëgjuar.

Cilat janë lidhjet tuaja me Shqipërinë? Përfshihet disi Shqipëria në projektet tuaja?

Në Shqipëri kam të afërm dhe sa herë më jepet të shkoj për t'i takuar nuk mendojem dy herë.

Përfshihet patjetër... Do të më pëlqente të dilnim në skenën shqiptare, por për mo-



mentin nuk kam ngut. Do të pres deri sa të vijë koha e duhur.

E ndiqni muzikën shqiptare? Ç'mendoni për rrokun apo edhe popin shqiptar sot? Ka grupe që i vlerësoni?

Muzikën shqiptare nuk e

kam ndjekur shumë. Mund të them se kam dëgjuar diçka dhe mendoj për shembull se Alban Skënderaj ka zë interesant. Nuk jam në gjendje të flas gjatë për këtë temë.

Cilat janë pikat tuaja të referimit në muzikën

ndërkombëtare?

Pikat e referimit janë të shumta... Radiohead, Sigur Ros, Kashmir, Death Cab For Cutie, Muse, Bjork, The Notwist janë vetëm disa prej tyre.

Bisedoi Marjola Rukaj

coop voce
La telefonia Coop

“NO FRONTIERE COOP”
PËR T’U NDIJER MË PRANË FAMILJES DUKE KURSYER!



Telefono në numra celulari dhe të telefonisë fikse me vetëm **18** qindarka për minutë.

Kërko informacion në pikat e shitjes **coop** dhe **ipercoop** që ke më pranë!

Tariffimi parashikon impuls përgjigjeje prej 15 qindarkash dhe parapaguhet çdo 60 sekonda. Tarifa e lehtësuar për trafikun ndërkombëtar të kryer është e vlefshme deri në arritjen e kufirit prej 550 minutave çdo 30 ditë. Me kapërcimin e këtij kufiri do të aplikohet tarifa e parashikuar

nga plani yt tarifar Coop Voce për thirrjet ndërkombëtare. Opsioni përtërrihet falas dhe automatikisht çdo 30 ditë nga aktivizimi. Minutat të trafikut që nuk janë përdorur nuk do të mund t'i shtohen kufirit të muajit pasardhës. Aktivizimi i ofertës do të të konfirmohet nga një SMS brenda 48 orëve nga kërkesa.

Convenienza e trasparenza



Të kalosh në CoopVoce për të folur me tarifa të volitshme është FALAS!

Paraqit këtë bonus në një pikë shitjeje COOP. Vlen një Aktivizim falas.

Është i vlefshëm për të marrë dhuratë një SIM CoopVoce që shitet më vete, deri më 30 Qershor 2009. Mund të përdoret vetëm një herë nga çdo klient.

188 Shërbim Asistence Klientëve

Falas nga celularët CoopVoce

Kushtet e Përgjithshme të kontratës i gjen në pikat e shitjes Coop dhe ne faqet internet **www.coopvoce.it**

abonohu në

Bota shqiptare

GAZETA E SHOIPTARËVE NË ITALI

fituese e mimit m.souhir 2005 të gazetarisë italiane si "gazeta më e mirë për të huajt në itali"

"Bota shqiptare" është prej dhjetë vitesh i vetri zë në gjuhën shqipe në shtypin italian

"Bota shqiptare" botohet nga e vetmja shtëpi botuese në gjuhën shqipe në Itali

"Bota shqiptare" nuk ka përfituar e nuk përfiton asnjë kontribut financiar publik italian apo shqiptar.

"Bota shqiptare" është e pavarur dhe jeton vetëmsajë shitjeve, abonimeve dhe reklamave

PAJTOHU PËR VETE
apo për t'ia bërë dhuratë një miku

abonimi për një vit (22 numra)

€ 35.00

ABONIMI MUND TË FILLOJË NË ÇDO PERIUDHË TË VITIT
PAGESA KRYHET PRANË ÇDO SPORTELI TË POSTAVE ITALIANE
nëpërmjet derdhjes së një buletini postar pagese
në llogarinë postare (conto corrente postale)
nr. 16831018 në favor të BOTA SHQIPTARE

Telefono në redaksi dhe kërkto të të nisimnumin e parë bashkë me fletën e abonimit të plotësuar.
Më ta marrë, të mbetet veç të shkosh në postë për të paguar.



BOTA SHQIPTARE, VIALE MARCO POLO 119, 00154 ROMA

REDAKSIA DHE SHËRBIMI I ABONIMEVE TEL 06-57289240 - FAX 06-62209543 - CEL. 339-6426836

redaksia@botashqiptare.net

Torinezët dëgjojnë ungjillin sipas Abbados". Kështu shkruanin gazetata italiane menjëherë pas koncertit të organizuar nga Associazione Lingotto Musica, duke i thurur elozhe sa dirigjentit historik të Mahler Chamber Orchestra, Claudio Abbado, aq edhe vetë orkestrës, korit të Radios së Suedisë dhe katër këngëtarëve "fuoriclasse" lirikë, ndër të cilët spikaste emri i tenorit me famë botërore shqiptarit Saimir Pirgu.

Në Torino dy koncertet "Requiem" të Orkestrës Mahler Chamber Orchestra, e drejtuar nga maestro Claudio Abbado, u zhvilluan në Auditorium Lingotto, ish-godinë e grupit FIAT, e transformuar në një nga sallat më prestigjioze të muzikës klasike në mbarë Europën. Ato u ndoqën nga mbi 2000 spektatorë të zgjedhur të shoqërisë së lartë torineze.

Pirgu 28 vjeçar, pas impenjimeve me Abbaddon dhe orkestrën Mahler në Torino e në Bolzano do të udhëtojë drejt Parisit, ku e presin 5 data të njëpasnjëshme, gjatë të cilave do të interpretojë përkrah Placido Domingos në operan "Cyrano de Bergerac".

Saimir Pirgu, 28 vjeçari Shqiptar me origjinë nga Elbasani është sot një nga tenorët më të njohur e më të kërkuar të skenës operistike ndërkombëtare. Me një ritëm prej enfant prodige, ai i përfundon në vitin 2003, në Konservatorin e Bolzanos, në Itali, studimet e nisura në moshën 6 vjeçare në qytetin e lindjes. Në Itali e ka zanafillën edhe karriera e tij profesionale. Po këtu, në 2004-ën, Saimir Pirgu debuton si profesionist, në moshën rekord 22 vjeçare, në rolën e Ferrandos, në operan moxartiane "Così fan tutte" të drejtuar nga maestro i madh italian Claudio Abbado. Që atëherë karriera e tij, e vlerësuar me çmime prestigjioze ndërkombëtare, ka shënuar vetëm rritje të shpejtë dhe suksese të njëpasnjëshme. I vlerësuar nga Pavarotti si një nga talentet më premtuese të lirikës botërore, Pirgu debuton në Vjenë, në Berlin, në Salzburg, në Romë, në Londër; në Paris, në New York e në Los Angeles, përkrah profesionistëve më të mëdhenj të skenës ndërkombëtare.

I intervistuar në Torino nga ATSH, ai rrëfen për publikun shqiptar etapat më të rëndësishme të karrierës së tij profesionale deri më sot. *be.gja.*



SAIMIR PIRGU

Vec krah emrash të mëdhenj

"Woody Allen qe thjesht një përvojë e bukur që më dha edhe më shumë vizibilitet mediatik, Por unë jam e do të mbetem tenor. Kam punuar deri më sot me dirigjentë maestro të mëdhenj të muzikës klasike si Abbado, Muti, Harnacourt, dhe ndihem me fat."

INTERVISTA

nga Benko Gjata, Torino

Koncerti i Torinos shënon për ju një rikthim. Atë të bashkëpunimit me Claudio Abbaddon. Si jeni njohur me maestron e madh?

Saimir Pirgu: Me Claudio Abbaddon jam njohur në vitin 2003, në një audicion për operan "Così fan tutte". Pak kohë më parë pata fituar në dy konkurse të rëndësishme kantoje çmimin "Enrico Caruso", në Milano dhe atë "Tito Schippa", në Lecce. Gjatë një audicioni, një person i afërt me Abbaddon më kishte pikasur dhe më


kishte prezantuar tek maestro.

Sot ju jeni një nga profesionistët më të kërkuar të muzikës lirike, një nga yjet e skenës operistike ndërkombëtare. Po cilat janë fillimet tuaja, ku e ka zanafillën rruga juaj drejt suksesit?

Studimin e muzikës e kam filluar në moshën 6 vjeçare. Talentin, apo më mirë prirjen time e ka "zbuluar" për herë të parë një mësues muzike. Në atë kohe mësuesit e muzikës shkonin në shkollë e kopshte për të përzgjedhur talentet e reja. Audicionin e parë ma kanë bërë në kopësht. Prindërit e mi më kishin regjistruar në shkollën "Jeronim de Rada", në Elbasan, të cilën duhej ta frekuentoja së bashku me vëllanë tim binjak, por një telegram ju 'komunikoi' se unë duhej të vazhdoja studimet në shkollën e muzikës, fillimisht për violinë.

Studiova në Elbasan, tashmë për kanto, deri në vitin e dytë të shkollës së mesme. Atje frekuentoja liceun artistik 'Onufri'. Pak a shumë në atë kohë kuptova se qyteti im i lindjes nuk mund të më ofronte mundësitë që kërkoja. Vendosa t'i vazhdoja studimet

vijon në faqen 20



vijon nga faqja 19

në Tiranë. Ju kërkova prindërve të mi të më ndihmonin për t'u transferuar. Mendoja të jetoja në konvikt, ndërkohë që do të vazhdoja studimet në liceun artistik "Jordan Misja" të kryeqytetit. Por im atë mendonte ndryshe. Ai është jetim. Dhe më tha se nuk dëshironte që edhe unë, djali i tij, të rritesha vetëm, duke jetuar në struktura publike, një përvojë të cilën ai e kishte kaluar vetë. Kështu, për të mbështetur aspiratat e mia, prindërit e mi shitën apartamentin tonë në Elbasan dhe të gjithë familjarisht u transferuam në Tiranë. Këtu kemi jetuar në një shtëpi me qera në periferi, në zonën e qytetit të nxënësve.

Në Liceun Artistik të Tiranës u diplomova në vitin 2000. Gjatë vitit të fundit të shkollës, Ambasada Italiane në Tiranë, ose më saktë Instituti Italian i Kulturës, na dërgoi disa formularë dhe materiale informuese për mundësitë e vazhdimit të studimeve të larta në Itali. Në materiale prezantoheshin 4-5 institute apo shkolla muzike ku mund të bëja kërkesë të shkoja, Accademia Santa Cecilia, Conservatori Giuseppe Verdi në Milano, shkollat në Bolzano, Torino, Bologna.

Përse zgjodhët pikërisht Bolzanon?

Mendova se konservatorët e Romës apo të Milanos, për shkak të flukseve të mëdha të kërkesave që ju drejtoheshin, nuk kishte shumë shanse të më përgjigjeshin. Ndërsa në Bolzano, këto shanse ishin më të mëdha. Ajo e Bolzanos ishte gjithashtu një shkollë mjaft prestigjioze, e cila frekuentohej nga emra të mëdhenj të muzikës botërore si pianisti Michelangeli. Atje zhvillohej gjithashtu edhe konkursi i njohur për piano 'Bossoni'. Bolzano ishte gjithashtu fare pranë Austrisë, e cila për mua ishte një alternativë e dytë, në rast se në Itali nuk do të më praninin.

Në atë periudhë, motoja e ditës ishte "të ikim nga Shqipëria", nuk pyesnim shumë se ku apo pse. Zgjedhja e shkollës ishte e rëndësishme, kjo nuk diskutohet, por prapë kryesore ishte të largohesh, si mënyrë për të rregulluar të ardhmen. Mbaj mend se fjalët e mia të fundit drejtuar prindërve të mi, përpara largimit nga Shqipëria ishin "Mos prisni të kthehem. Fitova s'fitova do të rri atje".


Në Bolzano pata bërë kërkesë për tu pranuar dhe ju nënshtrova konkursit. Komisioni i



SAJMI R PIRGU

Veç krah emrash të mëdhenj

„Ndoshta nuk ishte e lehtë për drejtuesit artistikë të "atdheut të lirikes", siç cilësohet Italia, të praninin që një shqiptar tu zinte vendin këngëtarëve Italianë. Xhelozia ndoshta u theksua edhe më atherë kur Pavarotti, në një intervistë dhënë gazetës La Repubblica, pohoi se ndër tenorët italianë nuk dallonte ndonjë pasardhës, por ndoshta do të ishte një Shqiptar ai që do ta zëvendësonte.



vlerësimit ishte i përbërë nga dhjetë persona. Në atë garë dola i pari.

Kursi i studimeve të larta për kanto në konservatorin e Bolzanos zgjaste pesë vjet. Unë arrita ta përfundoj, me rezultate të shkëlqyera, brenda 2 viteve të para. Gjatë asaj kohe më është dashur ta studjoj çdo lëndë veçmas, me profesorët e mi, pasi asnjë nga studentët e tjerë nuk ndiqte ritmin ti.

Studioja shpejt edhe për arsye të faktit se, në atdhe, familja ime po përballej me probleme ekonomike. Mbështetja e tyre nuk më ka munguar kurrë. Ata më patën dhënë gjithçka që kishin mundësi të më jepnin, madje kishin shitur edhe shtëpinë për të financuar studimet e mia. Kjo ishte për mua një përgjegjësi e madhe, ndonëse prindërit e mi nuk kanë përmendur kurrë. Kështu, me paratë e para të fituara bleva një shtëpi në Tiranë për familjen time. Në vitin 2002 fitova dy çmime të rëndësishme, "Enrico Caruson" në Milano dhe "Tito Schippan" në Leçe. Secili çmim shoqërohej me nga 10 mijë euro. Me këto para si garanci mora

huanë e parë bankare që më mundësoi financimin e blerjes së apartamentit.

Suksesi profesional i kësaj periudhe, flasim për vitet 2003-2004, u shoqërua edhe me rritjen e të ardhurave ekonomike. Dhe këtu më lindi një problem i paparashikuar. Prindërit e mi nisën të shqetësoheshin për burimin e të ardhurave të mia. Im atë kishte dyshime serioze përse i përket përfundimit të studimeve. "Të gjitha shkollat duan 5-6 vjet të përfundojnë," thoshte ai, "nuk të besoj që ti e ke mbaruar përpara kohe, pa parë diplomën". Unë isha diplomuar në vitin shkollor 2002-2003, me nota maksimale. Ama pergamenën zyrtare të diplomës, nuk e kam shtënë në dorë as sot e kësaj dite, për shkak të iterit të stërgjatë burokratik që karakterizon këtë procedurë në Itali. Kështu, materialisht nuk kisha se çfarë t'i tregoja! Në atë kohë unë kisha kënduar ndërkaq në një opera. Kisha bashkëpunuar gjithashtu me maestro Abbadon, një gjigand i skenës ndërkombëtare, por që nuk njihej thujse fare në Shqipëri. Por, fatkeqësisht, prindërit e mi nuk kishin mundur të vinin dot asnjëherë në Itali. Edhe sot e kësaj dite, pavarësisht suksesit tim dhe faktit se banoj në Verona, udhëtimet e tyre në Europë, për të më ndjekur mua, apo për motive personale mundësohen përherë nga viza të lëshuara nga shtete të tjera Europjane, si p.sh. Austria.

Pikërisht në Austri pata mundësinë të shfaqesha për herë të parë në skenë përballë prindërve të mi. Në vitin 2004,



pasi kisha bashkëpunuar në "Cosi fan tutte", të drejtuar nga Abbado, debutova në Vjenë me operan "Elisir D'amore". Ajo u transmetua drejtpërdrejtë nga televizioni austriak dhe kritika vendase i dha shfaqjes një jehonë të jashtëzakonshme. Në atë periudhë, një koleg hoqi dorë nga pjesëmarrja në Festivalin e Salzburgut, - festivali më i madh i muzikës lirike që zhvillohet sot në botë - dhe vendin e tij në operan "Cosi fan tutte", ma dhanë menjëherë mua. Në ato kohë isha si Aladini: mund të kërkoja çfarë të doja dhe do të më jepej. Kështu kërkoja që prindërit e mi të ishin të pranishëm në shfaqje. Ata udhëtuan me bileta të klasit të parë nga Tirana në Vjenë dhe prej aty u transferuan në Salzburg me një automjet të shtrenjtë me shofer. Për prindërit e mi ishte padyshim një përvojë e bukur dhe mendoj se aty, ndoshta, ata nisën të kuptojnë edhe profesionin tim.

Çfarë përfaqëson për ju pjesëmarrja në Festivalin e Salzburgut dhe në përgjithësi përvoja Austriake?

Festivali i Salzburgut është një moment i rëndësishëm i karrierës sime, pas bashkëpunimit të parë me Abbadon. Ai ishte për mua një lloj pasaporte. Unë isha dikush që maestro i madh e kishte zgjedhur. Por kjo nuk ishte e mjaftueshme. Pas bashkëpunimit të parë me të, në shumë audicione në Itali më kanë refuzuar; herë për shkak të moshës së re dhe herë të tjera për shkak se isha shqiptar. Ndoshta nuk ishte e lehtë për drejtuesit artistikë të "atdheut të lirikës", siç cilësohet Italia, të pranonin që një shqiptar tu zinte vendin këngëtarëve Itallianë. Xhelozia ndoshta u theksua edhe më atherë kur Pavarotti, në një intervistë dhënë gazetës La Repubblica, pohoi se ndër tenorët italianë nuk dallonte ndonjë pasardhës, por ndoshta do të ishte një Shqiptar ai që do ta zëvendësonte. Gjithsesi, ndërsa në Itali më refuzonin fitova një audicion në Staatsoper të Vienës, ku më lidhën menjëherë një kontratë dyvjeçare. Dho jo për role të vogla, por për role të rëndësishme. Pas kësaj përvoje të suksesshme edhe Italia u detyrua "të ulë kokën" përballë tal-

entit tim.

Keni deklaruar se kanë qenë pikërisht tre tenorët, gjatë një koncerti në Caracalla, të cilin e keni ndjekur në televizor, që ju kanë frymëzuar të bëheni këngëtar lirik. A keni patur rast të njiheni me ta?

Po, i kam njohur të tre. Me Pavarotin madje na lidhte një miqësi veçanarisht e fortë. Ndërsa me Domingon jemi kolegë, do të këndojmë së bashku edhe në këtë periudhë

A mund të na tregoni diçka më shumë për Pavarotin? Si jeni njohur me të?

Pavarotin mund të them se e kam njohur nga një rastësi fatlume. Në Bolzano nuk kisha shumë që kisha mbërritur, ndoshta nuk kishin kaluar ende gjashtë muajt e parë. Në atë peri-

udhë përpiqesha të mbijetoja duke marrë pjesë në koncerte të vogla të organizuara nga shoqatat artistike, ndërkohë që studjoja në konservatorin e qytetit.

Pavaroti shkante për pushime një herë në vit në një lokalitet aty pranë, në Merano, ku ndodhet një qendër e rëndësishme termale. Atje ai i nënshtrohej kurave dhe dietave të veçanta dhe përgjithësisht kishte mjaft kohë të lirë. Për këtë arsye thërriste pranë vetes miqtë e tij. Njëra prej tyre ishte një vajzë, një artiste nga Bolzano, të cilën ai e njihte prej vitesh. Pavaroti e pyeti me se po merrej në atë periudhë dhe ajo i tha se po vinin në skenë Traviatën, në formë koncerti. Maestro u interesua të dinte se kush ishte tenori dhe ajo ju përgjigj se ishte një djalë i ri 19 vjeçar, që isha unë. Pyetjes së Pavarotit për

vetitë e mia ajo ju përgjigj: "është i zoti, por 'bërtet' pak si tepër në veshët e mi". Kohë më vonë, pasi ishim bërë miq, maestro më ka treguar se i është përgjigjur duke i thënë: "mos u bëj kaq e keqe. Fakti që një tenor 19-vjeçar arrin të të 'bezdisi' ty, nuk aspak është shenjë e keqe. Sille njëherë ta dëgjoj". Dhe kështu ndodhi. Ajo i telefonoi profesorit tim, Vito Brunettit, në Bolzano dhe i kërkoi të shkonim të takonim Pavarotin.

Në atë kohë, për të financuar studimet punoja edhe si pjatolarës. Jetoja dhe punoja në një strukturë për studentë të administruar nga priftërinjtë Salesianë. Përpara se të shkoja të takoja Pavarotin kisha punuar në kuzhinë dhe, i inkurajuar' edhe nga mësuesi im, bëra dush për të hequr nga trupi erën e makaronave.

Rrugën për tek Pavaroti e kemi bërë me një Ford të vjetër. Kur mbërritëm nuk pata kohë as ti thoja mirëdita, hymë, si të thuash, direkt në thela. Ai më pyeti se çfarë dija të këndoja dhe ramë dakord për "Una furtiva lacrima". Pas dy versave të para më ndaloi dhe më pyeti: "Kush të ka mësuar të këndosh kështu!". Atë ditë këndova edhe disa herë të tjera për Pavarotin, i cili më lavdëroi.

Por ajo ditë mbaroi dhe nuk mendoja absolutisht se do të përsëritej më.

Kur, pas dy ditësh, dikush më mori në telefon dhe më tha, "Jam maestro Pavaroti dua të takohe mi sërish!" nuk e besova. Mendo-va se ishte mësuesi im, Vito Brunetti, që po tallej me mua. Faktikisht ishte Pavaroti dora vetë! Ai duhej të qëndronte 20 ditë në Merano dhe për fatin tim të mirë e kishte kohën të lirë. Punuam bashkë edhe rreth 10 ditë të tjera, të cilat qenë për mua një përvojë e bukur dhe e vyer. Me Pavarotin u lidhëm sërish kur fitova çmimet e para. Ai më përgëzoj dhe kur mësoi se do të debutoja me Abbadon më tha: "Ke hyrë nga dera kryesore. Përgatitu mirë pasi që këtë e tutje nuk të lejohet të gabosh".

Që nga ajo kohë kemi punuar shpesh së bashku. Ai më ftonte në shtëpinë e tij të frekuentuar nga artistë të mëdhenj si Juan

SAJMIR PIRGU

vijon nga faqja 21

Diego, Marcello Giordani apo Alania. Bisedonim, por kryesisht këndonim, në pozita të barabarta, si kolegë, ndonëse ai ishte një nga të mëdhenjtë e skenës ndërkombëtare. Miqësia jonë mbeti përherë shumë e fortë dhe unë isha ndër personat e paktë që ai, në porositë e tij të fundit, kishte lejuar të merrnin pjesë në funeralin e tij.

Po njohja me Placido Domingon?

Ndërsa me Placido Domingon jemi takuar në një mjedis pune. Unë punoja në operan e Vienës, ku ai bëri një audicion, në vitin 2006. Asokohe vinim në skenë Don Giovannin apo Traviatën. Ai kishte dëgjuar për mua, ndonëse nuk njiheshim. Audicioni ishte për operan "Gianni Schicchi", të cilën do ta drejtonte në Los Angeles regjizori i famshëm hollivudian Woody Allen. Domingo ishte drejtor artistik i "LA.Opera" dhe "Gianni Schicchi" u realizua me sukses vitin që shkoi. Këto ditë në maj, do të jemi bashkëprotagonistë në Paris, me operan "Cyrano de Bergerac" ku ai interpreton Cyranon, ndërsa unë Cristianin.

Si mund ta përshkruani përvojën me Alenin? A keni menduar ndonjëherë për ta "modifikuar" rrjedhën e karrierës suaj në drejtim të Hollywoodit?

Absolutisht jo. Përvoja me Allenin ishte interesante dhe mbi të gjitha e vlefshme nga pikëpamja e vizibilitetit mediatic. Por unë e dashuroj profesionin tim dhe nuk kam ndër mend asnjë zhvillim tjetër. Kam punuar deri më sot me dirigjentë maestro të mëdhenj të muzikës klasike si Abbado, Muti, Harnacourt, etj., dhe kur ke fatin të punosh me ta ndërton gur pas guri repertorin tënd. Pjesa më e madhe e artistëve që e kanë këtë fat arrijnë ta bëjnë këtë në moshën 40-50 vjeçare, kurse unë e kam patur që herët. Nuk kam ndër mend ta tradhetoj vokacionin tim.

Pavarotti, Domingo, Abbado, Muti, Harnacourt...nga Parisi në New York, nga Londra në Los Angeles, nga Vjena në Tokio. Të gjitha veprimtari të nivelit më të lartë. Mendoj se mund të pohohet se ju jeni një ndër shqiptarët më aktivë në skenën ndërkombëtare. Në një intervistë që keni dhënë kohët e fundit pohoni se e pranoni me kënaqësi rolin e ambasadorit Shqiptar në botë. A është me të vërtetë kështu?

Unë jo vetëm e pohoj një gjë të tillë, por e luaj tashmë këtë rol. Nuk kam nevojë të pajisem domosdoshmërisht me një pashaportë diplomatike për të përfaqësuar vendin tim, këtë punë e bëj vetvetiu, pasi është pjesë e veprimtarisë sime profesionale.

Zakonisht, pas një shfaqjeje, ne na presin ambasadorë e krerë shtetesh. Bashkë me maestro Abbado jemi të ftuar të marrim pjesë në një pritje që jepet për nderin tonë nga autoritetet më të larta të qytetit të Torinos. Këto janë mundësitë që na jepen.

Mbretëresha Elisabetë, sovranë e Mbretërisë së Bashkuar, pas shfaqjes së "Gianni Schicchi" në Londër, kërkoi të takohet personalisht me artistët. Ajo shpenzoi pak kohë me ne dhe u interesua për veprimtarinë tonë. Mendoj se shumë politikanë të botës do ta kishin për nder të takoheshin dhe të bënin fotografi me të. Kështu, për ne është ndoshta edhe më e lehtë të komunikojmë në një nivel të caktuar.

A keni marrëdhënie me botën artistike shqiptare?

Fatkeqësisht jo shumë. Pasi niveli profesional i veprimtarisë që zhvilloj ka nevojë edhe për një nivel të lartë përgatitje të gjithanshme organizative dhe administrative. Është folur p.sh. për të ftuar në Shqipëri Placido Domingon, ashtu siç është biseduar më parë edhe për të sjellë Pavarottin. Kurrë nuk është bërë gjë. Përshlyerja ime është se vendoset të futet dora në xhep vetëm atëherë kur ka ndonjë përfitim politik. Ndërsa unë mendoj se politika dhe arti duhet të konsiderohen si dy gjëra të ndara. Drejtori artistik është drejtor artistik, nuk ndryshon gjë nëse është i djathtë apo i majtë. Po kështu, nëse arti ka nevojë për një financim të caktuar, kjo nuk ka lidhje me kahët politikë. Shqipëria ka tashmë një traditë me operan dhe mendoj se duhet punuar për të mos e humbur. E kuptoj vendi ynë ka sot përparësi të tjera, pasi duhen rindërtuar shkollat dhe infrastrukturat e tjera, por mendoj se mund dhe duhet të ketë më tepër respekt edhe për artin dhe artistët.

Në Shqipëri dhe në botë studiojnë dhe punojnë më mijëra artistë të rinj shqiptarë. Edhe këtu, në Konservatorin e Torinos kanë kaluar vitet e fundit me qindra artistë shqiptarë. Pjesa më e madhe e tyre janë të rinj dhe mendoj se secili dëshiron suksesin, në fushën e tij. Çfarë mesazhi do t'ju përcillnit atyre?

Mesazhi im kryesor do të ishte të mos hiqnin kurrë dorë. Si edhe të studiojnë e të përgatiten shumë. Zakonisht në shkollë studjohet aq sa të japin, duhet bërë tre herë më shumë, përndryshe nuk je i ndryshëm nga shumë të tjerë. Secili ka fatin e tij dhe vendin e vet në botë. E rëndësishme është të japësh maksimumin dhe të arrish maksimumin e asaj që të lejojnë aftësitë e tua. Një tjetër gjë e rëndësishme është të mos jepesh kurrë, të mësosh të ringrihesh edhe pas ndonjë disfate. Në profesionin tim p.sh. përqendrimi mendor është shumë i rëndësishëm. Rolet ndërrojnë shpesh dhe po ashtu edhe partnerët e nivelit më të partë. Duhet të dish të adaptohesh dhe të përballësh çdo natë me një publik egzigjent prej mijëra vetash.

Intervistoi në Torino
Benko Gjata

Janë me mijëra studentët shqiptarë në Itali. Një realitet i prekshëm, i ndeshshëm nëpër gjithë atenuimet kryesore italiane. Ashtu si edhe emigrantët shqiptarë studentët janë të shpërndarë në gjithë territorin italian e madje edhe në skutat universitare më periferike e më të paimagjinueshme. Paraqesin një sërë karakteristikash të ngjashme me pjesën tjetër të emigrantëve e janë në të vërtetë një nga aspektet më të rëndësishme të emigracionit shqiptar veçanërisht në Itali. Por edhe pse për shumë arsye rëndësia e studentëve në këtë pjesë të shoqërisë shqiptare që ka emigruar, është e padiskutueshme, rrallë herë ndodh që studentët të jenë objekt studimesh apo hulumtimesh serioze për t'i njohur nga afër. Ajo që deri tani është bërë për ta nuk ka shkuar përtej retorikës së brain drainit e brain-gain-it simpoziumeve e konferencave të mbajtura solemnisht Rognerave e Sheratonëve të Tiranës. Lumi i fjalëve të derdhura për nevojën e ndërtimit të strategjive të veçanta për rimbledhjen e trurit, nuk ka prodhuar deri tani asnjë strategji të strukturuar për të realizuar të shumëdëshiruarin brain gain, dhe duket se qëllimi i vetëm që është realizuar ka qenë publicizimi i problemit, e i faktit se mijëra studentët shqiptarë studiojnë jashtë Shqipërisë, dhe se ata janë pjesë e vyer e trurit që do t'i nevojitej elitës shqiptare nesër, në të ardhmen e afërt, e madje në të tashmen. Në gjithë esetë, e sprovat që penat më të shqetësuarua kanë hedhur në letër për këtë temë përpikmërisht është theksuar se për studentët nuk ekzistojnë as statistika të mirëfillta, nuk dihet konkretisht sa janë, çfarë studiojnë, e ç'prirje kanë për të ardhmen e tyre. Kjo për të treguar se sa pak vëmendje i është kushtuar këtij fenomeni edhe pse prej të paktën 15 vjetësh ka përmasa masive në shoqërinë shqiptare. Studentëve përtej rievimit të tyre numerik nuk u dihet pothuaj asgjë. Ata përbëjnë një kontingjent, një pjesë të emigracionit shqiptar që nuk njihet, dhe madje shpesh herë nuk merret në konsideratë si e tillë, nisur përgjithësisht nga fakti se bëhet fjalë për një largim të përkohshëm nga atdheu që përputhet me kohën e studimit.

Në të vërtetë studentët janë emigrantë, sa efektiv aq edhe potencialë për tu shndërruar në mënyrë të qëndrueshme në pjesë të emigracionit shqiptar. Ndajmë shpesh të njëjtat probleme me emigrantët, por edhe me moshatarët e tyre të vendit ku studiojnë duke u bërë kështu një urë e ndërmjetme midis tyre. Por janë edhe tregues të situatës dhe pritmërive të vendit të origjinës e të vendit pritës ku jetojnë, në bazë të mënyrës se si e projektojnë të ardhmen e tyre. Janë po ashtu pasqyrë e integritimit apo e marrëdhënieve të çala ndërmjet dy komuniteteve.


Të gjitha këto janë të dhëna që do të ishin radhitur padyshim në një pyetësor të strukturuar nga çfarëdolloj entit që do të donte më së fundi të kalonte në sitë situatën e studentëve shqiptarë. Pikësepari për t'i njohur e më pas për të ndërtuar strategjitë ambicioze të brain-gainit apo për tu dhënë fjalën atyre vetë për të kuptuar nevojat e tyre.

(ma.ru.)

Bota shqiptare ka nisur një rubrikë kushtuar studentëve shqiptarë në Itali, për t'i njohur përtej numrave të ftohtë të statistikave të përvitshme. Për të zbuluar nëpërmjet vetë eksperiencës së gjithsecilit jetën e studentëve shqiptarë në Itali, qëllimet e tyre, marrëdhëniet me Shqipërinë e me Italinë, vështirësitë objektive e subjektive, botën e punës dhe përfytyrimin e të ardhmes. Për të pasur një panoramë të segmentuar përtej retorikës përshkruese të klisheve që mbulojnë fenomenin e studentëve në Itali.

STUDENTËT EMIGRANTËT E ARDHSHËM?

Quhem Gjergji Kajana, jam nga Berati dhe jetoj në Romë prej 7 vitesh e gjysmë.



Studioj Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin "La Sapienza" (me ç'thonë edhe akademikë të kualifikuar, një ndër më të mirët e Evropës). Zgjedha Shkencat Politike sepse gjithmonë më kanë pëlqyer degët shoqërore e aspektet politiko-historike të realitetit ndërkombëtar.

Kam zgjedhur Italinë për shkak të njohjes së mirë të gjuhës italiane qysh në Shqipëri dhe njohjes gjithashu të aspekteve të gjera të jetës e kulturës italiane përmes medias televizive.

Aktualisht jam i regjistruar në vitin e parë të diplomës së nivelit të dytë në Shkenca Politike e Marrëdhënie Ndërkombëtare: mendoj se studimet do t'i përfundoj brenda dy vitesh.

Jam i kënaqur prej zgjedhjes sime sepse arrita të diplomohem të paktën në nivelin e parë, nëntorin e kaluar me notën 95/110; dikujt tjetër në atdhe do t'ia këshilloja Italinë në krahasim me vende si Greqia e Rumania, por kush ka mundësinë të studiojë në SHBA, Angli, Francë e Gjermani le të vrapojë atje: Italia vjen pas tyre për nga cilësia!

Aktualisht shpenzimet e mia i përballoj gati të gjitha vetë duke punuar, i ndihmuar edhe nga kësti i pare i bursës 2008/2009. Bursa ndihmon shumë por nuk i mbulon dot krejt nevojat ekonomike të kujt do të riu student.

Te jesh student shqiptar në Itali është një përvojë formuese jete e studimi në një vend padyshim të zhvilluar-

megjithëse me pabarazi shoqërore të theksuara - e kulturualisht perëndimor. Me sa i shoh unë, italianët kanë konceptualisht probleme në pranimin e diversitetit kulturor: i pandehuri "racizëm" i tyre qëndron këtu. Unë personalisht nuk kam hasur probleme racizmi ndaj vetvetes për shkak te origjinës sime etnike; madje ndaj nesh italianet janë kureshtarë. Unë nuk perceptoj racizëm në Itali.

Më tepër se Shqipëria Italia me ka ofruar mundësinë e një konkurrimi akademik të vërtet: diploma italiane vlen vërtet sepse duhet djersitur deri në fund, titujt akademike të Shqipërisë janë të vërtetë vetëm në kopertinë.

Te ardhmen time e shoh në një vend evropian. Kur erdha mendoja se një dite do të kthehesha, sot nuk e di nëse do të kthehem apo jo së shpejti në atdhe.

Ndonjëherë mendoj se një vend i tretë evropian (ndoshta Franca apo Anglia) është më mirë se Italia. Por "kontrata" ime me Italinë ka ende disa vite vlefshmëri e unë do ta respektoj.

Në mjedisin universitar frekuentoj më shumë shqiptarë se italianë; por kam mar-

STUDENTËT SHQIPTARË NË UNIVERSITETET ITALIANE

viti akademik	shqiptarë
2003-2004	8,257
2004-2005	9,552
2005-2006	10,543
2006-2007	11,415

STUDENTË SHQIPTARË TË REGJISTRUAR NË VITIN E PARË

2003-2004	2,508
2004-2005	2,437
2005-2006	2,284
2006-2007	2,232

rëdhënie korrekte me studentet vendas ose "globale" gjithashtu.

Marrëdhëniet mes dy komuniteteve më ngajnë formalisht korrekte; fatkeqësisht, ka pak bashkëpunim.

Në kohën e lirë shoh TV, frekuentoj Internetin e lexoj shumë botime italiane jashtëshkollore gjithashtu pasi më tërheq njohja e botës së vendit ku jetoj prej vitesh.

J.B.
Jam nga Tirana. Jetoj në Romë. Jam në Itali prej 7 vjetësh, kam mbaruar fakultetin e mjekësisë.

Zgjedha këtë sepse mendoj se jam i prerë për këtë punë. Pres të specializohem në urologji. Pse kam ardhur në Itali nuk e mbaj mend. Sot, nuk do ia sugjeroja askujt të vinte të studioje në Itali.

Shpenzimet e mia i përballoj, pak me punë, pak me ndihmën e familjes, por dhe bursa mjafton po te shtrëngosh rripin.

Perceptoj goxha racizëm.

Italia nuk di të them çfarë më ka dhënë më shumë se Shqipëria, mbase pak më shumë eksperiencë dhe nga vetë jeta.

Jam thjesht kureshtar të di sa shqiptarë jemi që studiojmë këtu.

Veten e shoh patjetër dhe vetëm në Shqipëri, dhe nuk e kam menduar ndonjëherë të qëndroj në Itali. Ndoshta në një vend të tretë po, mbase diku tjetër në Evropë.

Marrëdhëniet mes nesh dhe italianëve janë të mira, normale dhe unë nuk bëj dallime mes njerëzve që frekuentoj për nga kombësia.

Kohën e lirë e kaloj duke lexuar libra, më shumë shqiptarë sepse jam i interesuar të mos harroj të flas dhe të shkruaj mirë shqipen ndryshe nga qeveritarët tanë.

GRANDE SPETTACOLO A RIMINI

Domenica, 21.06.2009 Ore 15.00 Albania in concerto!

*Dall' Albania gli artisti più famosi
Musica moderna e popolare e comici attuali*

CANTANTI

MEDA - ÇILJETA - ELI FARA
"Grupi Djemtë e Detit" GENTI
LIRIO NUSHI - LULI - ILIR VELIU

COMICI

BEHAR MERA - RITA LATI
GJINI PORTOKALLI

PRESENTA
SILVANA BRAÇE

SI RINGRAZIANO LE IMPRESE EDILI ALBANESE
DI RIMINI E D'INTORNI PER IL SOSTEGNO

*Një spektakël i vërtetë!
Në një sallë komode
dhe familjare*

**100%
LIFE**

Grafica: agronceka@libero.it

I PRIMI POSTI IN SALA RISERVATI IN BASE ALLE CHIAMATE



**CENTRO CONGRESSI EUROPEO
BELLARIA - IGEA MARINA (RN)
VIA USO, 1 - CAP. 47814
A14 - USCITA RIMINI NORD**



ORGANIZZANO:
Associazione italo-albanese
"AMICIZIA" onlus
WEB: <http://dijilander.libero.it/italbarimini/>

ARBËRIA
L'unico Circolo
di cucina Balcanica
a Bellaria (RN)

Informazioni e prenotazioni: Agron Çeka 3284861091 Email: italbarimini@libero.it

Luan Koni 3483999301

ASUF

“Albania il paese di fronte” ngjall debatin me studentëve shqiptarë të Universitetit të Firences


Shfaqjet publike me praninë e autorit janë të vetmet mundësi që e ballafaqojnë këtë të fundit me shikuesin për të cilët ajo vepër është ndërtuar. Për autorin, prania e pjesëmarrjes nuk është nevojë vetjake për të përçuar më tej me fjalët e diskutimeve pasuese atë që ka dashur të rrëjëjë nëpërmjet njetit filmik, por është pikësëpari, një kauzë e cila, e përzier me sedrën autoriale, lejon që ballafaqimi me shikuesin të shndërrohet në një dialog të realizuar; ndryshe nga i njëjti dialog që shikuesi bën me veprën filmike vetëm për vetën me ekranin gjatë shijimit.

E më e madhe është kënaqësia dhe pjesëmarrja e një autori kur vëren se shikuesit këtë dialog të brendshëm me veprën, këtë përjetim me një dokumentar ku shihet të rindërtuar nëpërmjet imazheve historinë e vendit të vet, e shpërthen në debat. Jo vetëm nëpërmjet pyetjeve kauzësore, por sidomos nëpërmjet shprehjes së gjendjeve emotive që dokumentari i ka krijuar: E meqë ky dokumentar, i pari në llojin e vet, rindërton në 90 minuta historinë e Shqipërisë, thujtë të gjithë me pjesëmarrjen e tyre shprehin, me apo pa dashje, pikërisht këtë përjetim të historisë.

I tillë ishte debati i organizuar në Firencë mbrëmjen e 7 majit pas shfaqjes së dokumentarit "Albania il paese di fronte" organizuar nga shoqata studentore shqiptare ASUF në kinemanë e Godinës së Studentit Calamandrei, ku salla e mbushur plot nuk u boshatis aspak pas shfaqjes, për t'i lënë vendin një debati të këndshëm, të edukuar por aty këtu edhe të zjarrtë, mbi temat e trajtuara në dokumentar, dhe përjetimin e përgjithshëm. Lavdet apo kritikët ia lanë vendin shpejt përcjelljes së gjendjeve shpirtërore dhe meditimit mbi të shkuarën dhe atë ardhmen e shqiptarëve duke krijuar një atmosferë me nivel të lartë debati, respekt për folësin dhe mendimin edhe kur që i kundërt, që aq shumë i mungon tregu televiziv apo mitingjeve të realitetit shqiptar. Përveç kësaj, theu, për mua, i infektuar sadopak nga besimi i përgjithshëm se studentët shqiptarë, 20-vjeçarët e sotëm, kanë humbur interesin për vendin e tyre, atë mit që shpesh nuk na lejon të njohim më as bashkatdhetarët tanë me ndryshim brezor. Për këtë, e për të gjitha të tjerat, i falënderoj.

Pjesëmarrje e lartë e studentëve shqiptarë gjatë shfaqjes të organizuar nga ASUF. Debat i pasues mes studentëve e regjisorit thyen mitin e gabuar se studentët shqiptarë në Itali janë të shkëputur e të painteresuar për temat historike shqiptare

Pamje nga diskutimi pas shfaqjes së dokumentarit "Albania il paese di fronte" organizuar nga shoqata ASUF e Firences
Foto Mark Gjeka



“MIQËSIA” E RIMIT FTON SHQIPTARËT NË NJË KONCERT TË RI

Mes dhjetëra shoqatave shqiptare në Itali spikat për veprimtarinë e saj "Miqësia" në Rimini. Në jetën e saj tashmë 10-vjeçare, vërehet përpjekja e vazhdueshme për të rikrijuar lidhjet mes shqiptarëve me njeri-tjetrin dhe ruajtjes së kontakteve me atdheun. Kjo është arritur përmes organizimeve të shumta tematiko-artistike. Shënojme si të rëndësishme krijimin e shkollës në gjuhën shqipe, bibliotekën me libra të autorëve tanë më të njohur dhe përkthime në gjuhën shqipe të kryeveprave nga letërsia botërore. Gjithashtu në spektrin e aktiviteteve kjo shoqatë ka përfshirë dhe sportin duke zhvilluar talentin e të rinjve shqiptarë në Rimini në skuadrën e futbollit të quajtur "Aquila", e cila luan në kategorinë e dytë dhe ka në vitrinën e suksesit dhjetëra trofe. Një moment tjetër i rëndësishëm i "Miqësisë" është dhe organizimi i koncerteve e spektakleve festive. Është e tepërt të rrëfejme kompaktin e mrekullueshëm që këto aktivitete kanë të shqiptarët e Rimitit dhe të zonës. Përzgjedhja e artistëve më të njohur të muzikës dhe humorit shqiptar bën që në këto koncerte të ketë një pjesëmarrje masive dhe të hareshme. Në organizimet e suksesshme të këtyre spektakleve në Rimini, një rol të padiskutueshëm ka çifti Silvana Braçe, prezantuesja jonë më të njohur e Tvsh-së, dhe Agron Çeka, kryetar i shoqatës "Miqësia".

Duke qenë se këto organizime të mëdha s'janë as të lehta dhe as pa shpenzime, realizohen vetëm 1 ose 2 herë në vit. Këtë herë spektakli i radhës është ai i datës 21 qershor në Qendrën e Kongreseve në Bellaria (Rimini). Do të jenë të shumtë artistët, prej të cilëve veçojmë, këngëtarin e mirënjohur kosovar, Meda, Çiljetën, të mirënjohurën Eli Fara me perlat e jugut, dhe shumë këngëtarë të tjerë si përfaqësues të një brezi më të ri dhe që pasurojnë gjeografinë e spektaklit me Vlorën, Fierin, Lezhën, Shkodrën etj. Humorin do të sjellë çifti i mirënjohur Behar Mera dhe Rita Latë, dhe nga "Portokalli", vjen një nga personazhet më të dashur, Gjini.

Spektakli do të ketë dhe lojë shpërblyese dhe befasi të tjera që organizatorët i ruajnë ende të patreguara.

Bashkimi familjar mund të kërkohe vetëm për familjarë të caktuar shprehimisht nga ligji (meni 29 i T.U. mbi Imigracionin i modifikuar nga dekreti legjislativ 160/2008, në fuqi nga 5 nëntori 2008).

Në veçanti ligji parashikon që shtetasi i huaj me leje qëndrimi BE për qëndruesit afatgjatë apo me leje qëndrimi me kohëzgjatje të paktën njëvjeçare të lëshuar për punë të varur, për punë të pavarur, për strehim politik, për studime, për motive fetare, për motive familjare dhe mbrojtje e mbështetje ekonomike, mund të kërkojë bashkimin familjar me këta të afërm:

- bashkëshortin në moshë madhore, me të cilin është ligjrisht i pandarë;

- bijtë në moshë të mitur (edhe të bashkëshortit apo të lindur jashtë martesë) të pamartuar, me kusht që prindi tjetër të ketë dhënë pëlqimin;

- bijtë në moshë madhore në ngarkim, vetëm nëse për arsye objektive nuk mund t'i bëjnë ballë nevojave të domosdoshme të jetesës për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore që u ka shkaktuar invaliditet të plotë;

- prindërit në ngarkim, nëse nuk kanë bij të tjerë në atdhe ose nëse janë mbi 65-vjeç e bijtë e tjerë nuk mund t'i mbajnë për motive të rënda shëndetësore të dokumentuara.

Kushtet

Kushtet e kërkuara me ligj për të gëzuar të drejtën e bashkimit familjar janë:

- të ardhura minimale të mjaftueshme, që vijnë nga burime të ligjshme, jo më të ulta se çeku social vjetor (për vitin 2009, 5.317,65 euro) shtuar me gjysmë çeku për çdo familjar që kërkohe të sillet në Itali;

- përshtatshmëria e strehimit që mund të dëshmohe me:

1. certifikatën e përshtatshmërisë së strehimit të lëshuar nga Zyra teknike e Komunës ku ndodhet banesa (në certifikatë shënohet numri maksimal i personave që mund të banojnë në banesë sipas parametrevë minimalë ta parashikuar nga ligjet krahinore dhe rregulloret komunale për ndërtesat për banim);

2. përmes dëshmisë higjienike-sanitare (Parere igienico sanitario) të lëshuar nga Zyra e higjienës publike të ASL-it të territorit (dëshmon që ndërtesa është e përshtatshme

BASHKIMI FAMILJAR

Për cilin familjar mund të kërkohe?

për banim nga ana higjienike dhe sanitare sipas parametrevë të vendosur nga Ministria e Shëndetësisë).

Këto dokumente mund të kërkohe në Komunë ose në ASL, nga pronari, qiraxhiu apo nga ai që jeton falas në shtëpi; në rastin e fundit, nevojitet t'i bashkëngjitet kërkesës edhe deklarata e bujtjes së titullarit të banesës me fotokopjen e dokumentit të tij të identifikimit.

Në rast se kërkohe bashkimi familjar me vetëm një bir nën moshën 14 vjeç, mjafton një deklaratë pëlqimi e pronarit të shtëpisë ku do të jetojë i mituri; pra në këtë rast nuk është e nevojshme të certifikohet për-

shtatshmëria e strehimit.

Këto rregulla nuk vlejnë kur:

1. bashkimi kërkohe për dy a më shumë bij nën moshën 14-vjeçare;

2. bashkimi për dy a më shumë familjarë kërkohe nga të huaj që gëzojnë statusin e mbrojtjes ekonomike. Në këto raste kërkohe të ardhura vetëm sa dyfishi i çekut social (10.635,30 euro).

Sidoqoftë, në llogaritjen e të ardhurave të nevojshme për bashkim familjar do të merren në konsideratë të ardhurat vjetore të të gjithë familjarëve që bashkëjetojnë me personin që paraqet kërkesën.

LEJA E QËNDRIMIT

Mund të shihet edhe on-line nëse është gati apo jo

Për të shmangur radhët përpara zyrave të imigracionit të kuesturave për të mësuar nëse leja e qëndrimit është apo jo gati, Policia e shtetit ka realizuar një bankë të dhënash që mund të konsultohet on-line nga kushdo. Kush është në pritje të lejes së parë të qëndrimit, të përtëritjes apo publikimit, nga 29 prilli mund të lidhet me ueb-site-n e policisë (www.poliziadistato.it) në seksionin "stranieri" dedikuar të huajve që i lejon të kontrollojë bankën e të dhënave. Shërbimi ofrohet edhe në www.poliziadistato.mobi, gjithnjë në seksionin për të huajt, që konsultohet nga celularët.

Pasi zgjedh gjuhën që di më mirë (shërbimi ofrohet në disa gjuhë por jo në shqip: italisht, anglisht, frëngjisht, rusisht, spanjisht dhe arabisht), i interesuari shkruan në hapësirën e përcaktuar kodin numerik të praktikës së tij, nëse kërkesën e ka paraqitur në Kuesturë, ose kodin e kuponit të dërgesës së siguruar postare, nëse kërkesën e ka paraqitur në një sportel poste.

Pas pak çastesh kërkimi mes të dhënave të regjistruara shërbimi ofron informacion mbi gjendjen e praktikës në atë çast: nëse leja është gati, tregon edhe zyrën ku duhet shkuar për të tërhequr dokumentin, në rast se nuk është gati thotë vetëm "il permesso non è pronto" por nuk jep asnjë sqarim të mëtejshëm se në ç'pikë ka arritur praktika.

Policia e shtetit sqaron që mbesin të pandryshuara të gjitha praktikat për prenotimin e tërheqjes së dokumentit, që vendosen nga vetë kuesturat.

Nga 5 nëntori 2008 bashkimet familjare janë edhe më të vështira. Nevojiten të ardhura më të larta dhe për prindërit mbi 65 vjeç sigurim shëndetësor privat

Sigurimi shëndetësor për prindërit mbi 65 vjeç

Kush kërkon bashkim familjar për prindin mbi 65 vjeç, duhet të lidhë një sigurim shëndetësor privat të vlefshëm në territorin italian, ose të regjistrojë prindin vullnetarisht në shërbimin shëndetësor kombëtar SSN kundrejt një pagese që ende nuk është përcaktuar nga ministria e Punës në bashkëpunim me atë të Ekonomisë dhe Financave. Dhe meqë kjo shumë për regjistrimin e prindërve në SSN ende nuk dihet, e vetmja rrugë që mund të ndiqet është lidhja e sigurimit privat.

Gjithashtu, duke konsideruar kohën e gjatë që kalon nga paraqitja e kërkesës për bashkim familjar deri në ardhjen në Itali të familjarit, i interesuari në çastin e paraqitjes së kërkesës nënshkruan një dokument me të cilin merr përsipër se do të bëjë sigurimin shëndetësor për prindin, dhe e lidh konkretisht kontratën e sigurimit brenda tetë ditëve të para nga data e hyrjes së prindit në Itali, përpara se të paraqitet në Sportelin Unik për lejen e qëndrimit.

Si paraqitet kërkesa për bashkim familjar

Kush përmbush kushtet e sipërpërmendura mund të paraqesë kërkesë për bashkim familjar duke ia përcjellë Sportelit Unik kompetent për zonën e rezidencës përmes procedurës së informatizuar të ministrisë së Brendshme (duke u lidhur me faqet internet interno.it).

Formulari që duhet përdorur është 'modello S', që përmban edhe udhëzimet mbi përpilimin e tij dhe dokumentet e nevojshme për të treguar të ardhurat dhe përshtatshmërinë e strehimit. Sporteli Unik kompetent, pasi merr kërkesën, thërret të interesuarin për paraqitjen e dokumenteve mbi të ardhurat dhe strehimin.



Identiteti dhe kulturat e një kryeqyteti multi etnik

Tregoni historinë tuaj



Dërgo fotografi, video dhe mesazhe zanore tek

www.migrart.it



contrasto



Ligji në fuqi parashikon mundësinë që shtetasit e huaj të lidhin martesë në Itali, edhe pse pa lejen e qëndrimit. Pra aktualisht, të huajt mund të martohen në Itali, edhe pse nuk kanë qëndrim të rregullt këtu, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj edhe për shtetasit italianë, si për shembull, afri gjaku mes dy bashkëshortëve të ardhshëm.

Kujdes, ç'thamë më lart është e vlefshme deri në ardhjen në fuqi të ligjit të ri të sigurisë që përmban një normë që parashikon detyrimin e paraqitjes së dokumentit të qëndrimit edhe për rastin e martesës. Por aktualisht kjo normë ende nuk është në fuqi.

Dokumentacioni i nevojshëm

Për t'u martuar në Itali, praktikisht bashkëshortët e ardhshëm duhet të kërkojnë autorizimin për martesë, që është një certifikatë që dëshmon se nuk ekzistojnë pengesa për martesë (p.sh. që secili prej dy personave që do të martohen nuk është i lidhur aktualisht në një martesë tjetër) dhe lëshohet vetëm kur kërkuuesi është beqar, ligjrisht i ndarë apo i ve.

I huaji i drejtohet përfaqësisë konsullore të vendit të tij për të marrë këtë certifikatë, i pajisur me dokumentin e tij të identitetit. Në rastin e shqiptarëve, i interesuari i drejtohet njëerës prej konsullatave (Romë, Bari, Milano) për të kërkuar këtë dokument, që nuk jepet në çast por pas një periudhe të caktuar pasi konsullata ia përcjell kërkesën për autorizim martesë Zyrës së gjendjes civile kompetente në Shqipëri e pret përgjigje prej saj.

Më pas autorizimi për martesë i marrë në konsullatë duhet të legalizohet në Zyrën e legalizimeve të Prefekturës në Itali të zonës ku është rezident i interesuari.

Më pas dy bashkëshortët e ardhshëm mund të shkojnë në Komunë dhe të kërkojnë shpalljen e martesës dhe të ndjekin rrugëtimin e zakonshëm deri në celebrimin e martesës.

Kujdes, në pritje të martesës, qytetari i huaj pa leje qëndrimi, nuk është i autorizuar të qëndrojë në territorin italian, e fiton këtë të drejtë vetëm nga çasti i martesës me italianin. Ndaj në çdo çast para martesë

Martesa me italian dhe LEJA E QËNDRIMIT

Sot klandestinët mund të martohen me një shtetas italian e të marrin dokumentin e qëndrimit. Me ardhjen në fuqi të ligjit të ri mbi sigurinë, kjo nuk do të jetë më e mundur



rrezikon të marrë dëbimin, si çdo klandestin tjetër.

Martesa dhe ndalimi i dëbimit

Pas martesës, i huaji, edhe pse pa leje qëndrimi apo i goditur nga dekreti i dëbimit, nuk mund të dëbohet nga Italia, nëse tregon drejtpërdrejt në Kuesturë, martesën dhe bashkëjetesën me shtetasin italian. Ky ndalim dëbimi është shprehimisht i përcaktuar nga normat italiane mbi emigra-

cionin që parashikojnë edhe të drejtën e marrjes së lejes së qëndrimit për motive familjare për bashkëshortin e huaj bashkëjetues me italianin (neni 19, paragrafi 2, germa C i Tekstit Unik mbi imigracionin dhe neni 28 DPR 394/99).

Kërkesa për lejen e qëndrimit

Enti kompetent ku mund të kërkohet leja e parë e qëndrimit për motive familjare të parashikuara në nenin 19 të

Tekstit unik të Imigracionit është vetëm Kuestura, ndërsa për përtëritjen e dokumentit kërkesa mund të paraqitet me kompletin e formularëve pranë zyrave postare.

Vetëm pas celebrimit të martesës, shtetasi i huaj mund të paraqitet personalisht pranë zyrës së Imigracionit të Kuesturës me këto dokumente: dokument identiteti të paskaduar (pasaportë); certifikatë martesë; pullë-postë prej 14,62 euro; 4 fotografi; deklaratën zëvendësuese të aktit noterial të bashkëshortit italian mbi adresën e banimit dhe deklaratën e marrjes në ngarkim (deklaratë me të cilën bashkëshorti italian merr përsipër të mbajë ekonomikisht familjarin e huaj); fotokopje të dokumentit të identitetit dhe të certifikatës së rezidencës së bashkëshortit italian.

Kuestura ka kompetencë ekskluzive për lëshimin e lejes së qëndrimit sepse, pas paraqitjes së kërkesës, duhet të verifikojë, përveç martesës edhe bashkëjetesën efektive të bashkëshortëve në adresën që japin.

Pas paraqitjes së kërkesës, familjari i huaj duhet të jetojë vërtet në adresën e bashkëshortit italian, pasi Kuestura do të bëjë kontroll të befasishtëm.

Nëse pas kontrolleve, Kuestura vërteton që bashkëshortët nuk jetojnë bashkë, i mohon lejen e qëndrimit për motive familjare të huajt. Në fakt, bashkëjetesa është kusht i domosdoshëm për aplikimin e normës mbi ndalimin e dëbimit sipas nenit 19 të T.U. mbi Imigracionin.

Bashkëshorti i huaj ka të drejtën e 'kartës së qëndrimit për familjar të një shtetasi të BE-së' në bazë të dekretit legjislativ 30 /2007 dhe më pas të kërkojë shtetësinë italiane.

Rosanna Caggiano

LEJA E QËNDRIMIT NË KOHË REKORD

Nis eksperimentimi në Firenze, Siena e Viterbo

Për vitetash më përtëritja e dokumenteve të qëndrimit në Itali është kthyer në një makth të vërtetë për emigrantët. Përveç dokumentacionit të shumtë që duhet paraqitur, ajo që shqetëson më shumë është koha e gjatë të cilës qindra mijëra vetë mbeten pa dokumentin në xhep, duke hasur dhjetëra vështirësi në jetën e përditshme, nga regjistrimi i fëmijëve në shkollë, te marra e një kredi për të blerë shtëpinë.

Më në fund, një procedurë e re, që ka për qëllim pikërisht lëshimin e dokumentit të qëndrimit brenda një muaji, maksimumi 45 ditëve, ka nisur në rrugë eksperimentale në kuesturat e Firences, Sienës dhe Viterbos. E nisur prej mëse një muaji (më 16 mars ka filluar e para kuestura e Firences) ka dhënë tashmë rezultatet e pritura: që në fund të prillit në këto kuestura janë shpërndarë leje e karta qëndrimi të kërkuara rreth një muaj më parë.

Praktikisht procedura e re parashikon që të jenë drejtpërdrejt Postat Italiane ato që lajmërojnë të huajt për datën e takimit pranë Zyrës së Imigracionit për dhënien e shenjave të gishtërinjve, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës. Ndërkohë Postat i përcjellin telematikisht kërkesën Kuesturës dhe kjo e fundit i merr të huajt shenjat e gishtërinjve dhe fotot në datën e caktuar nga Postat. Më pas kërkesa i kalon Tipografisë së shtetit që brenda 30 ditëve shtyp dokumentin e qëndrimit.

Tani për tani, ky është realiteti i vetëm tre prej provincave italiane, ku jetojnë rregullisht rreth 23 mijë shqiptarë (rreth 16 mijë në Firenze, 5 mijë në Siena dhe 1.600 në Viterbo). Shpresojmë që së shpejti të shtrihet në mbarë Italinë e veçanërisht në provincat me problemet më të mëdha si Romë, Milano, Napoli, Brescia ku emigrantët presin të marrin dokumentin e qëndrimit edhe 18 muaj.

Çeku social dhe llogaritja e të ardhurave për bashkimet familjare

Ja sa duhet të fitojë një i huaj që të mund të sjellë familjarët e tij në Itali

INPS-i e ka vlerësuar në masën 409,05 euro, shumën mujore të çekut social për vitin 2009, një formë asistence sociale për të moshuarit më të varfër.

Çeku u jepet shtetasve italianë dhe komunitarë që janë të paktën 65 vjeç dhe që kanë të ardhura vjetore jo më të larta se 5.317,65 euro, pra sa shuma e çekëve sociale për 13 muaj. Shtetasi jo komunitarë mund të përfitojnë këtë të drejtë vetëm nëse janë rezidentë në Itali prej të paktën dhjetë vitesh dhe nëse janë të pajisur me një lejeqëndrim CE për "rezidentë afatgjatë" ose disponojnë një kartë qëndrimi.

Në të vërtetë gjyshët e imigruar që plotësojnë këto kushte janë të paktë, por çeku është i rëndësishëm sepse shuma e tij e tanishme shpesh merret si parametër referimi nga normativa e imigracionit, për të vlerësuar mundësitë ekonomike të të huajit. Kështu për shembull, për të marrë në 2009 përtëritjen e lejeqëndrimit për arsye pune, duhet të

tregohet se së bashku me të gjitha kushtet e tjera fitohen të ardhura prej të paktën 5.317,65 euro.

Në të tjera raste kjo vlerë bazë shumëfishohet, siç ndodh për bashkimet familjare.

Nga 5 nëntori janë në fuqi rregullat e reja mbi të ardhurat e nevojshme për bashkimet familjare. Në përgjithësi kush kërkon të sjellë në Itali familjarë të tij duhet të ketë të ardhura sa çeku social për vete dhe gjysmë çeku social për çdo familjar që kërkon të sjellë. Me përjashtim të disa rasteve të veçanta të parashikuara shprehimisht në ligj si kur është fjala për bashkim familjar me dy a më shumë bij të mitur nën 14 vjeç apo kur bashkimi familjar për dy a më shumë persona kërkohet nga persona që gëzojnë statusin e të mbrojturit

ekonomikisht. Në të dyja këto raste të veçanta shuma e kërkuar është të paktën sa dyfishi i çekut social, 10.635,30 euro. Ja disa shembuj konkretë.

Bashkim familjar me gruan

Shtetasi i huaj, rezident në Itali, që kërkon bashkimin familjar me gruan e tij duhet të fitojë në vit të paktën 5.375,65 euro për vete, dhe 2.658,82 euro për gruan. Pra të ardhurat e tij vjetore duhet të jenë, të paktën 7.976,48 euro.

Bashkim familjar me gruan dhe një fëmijë

Në këtë rast i huaji që paraqet kërkesë duhet të fitojë të paktën 5.317,65 euro për vete, 2.658,82 euro për gruan dhe 2.658,82 për fëmijën, pra të ardhurat e tij vjetore nuk mund të jenë nën

10.635,30 euro.

Bashkim familjar me gruan dhe tre fëmijë mbi moshën moshën 14 vjeç

Në këtë rast i interesuari duhet të fitojë në vit, përveç shumës së një çeku social për vete edhe gjysmë çeku për secilin prej familjarëve, pra duhet të ketë të ardhura vjetore të paktën sa trefishi i çekut social, pra 16.126,95 euro.

Bashkim familjar me gruan dhe tre fëmijë nën moshën moshën 14 vjeç

Në këtë rast i interesuari duhet të fitojë në vit, sa shuma e dy çeqeve për vete dhe tre fëmijët (meqë janë nën 14 vjeç) dhe gjysmë çeku për gruan, pra ai duhet të fitojë gjithsej jo më pak se 13.294,13 euro.



Një tezgë në treg për Johnin

Të marrësh iniciativën, të projektosh një sipërmarrje mund të mbetet vetëm një ëndërr nëse nuk keni mundësi të merrni një hua. Tani të hapësh një dyqan, të blesh mjetet, apo një furgon mund të bëhet nga kushdo që merr iniciativën të investojë, falë shërbimeve të mikrokredive të PerMicro.

John-it, 33 vjeç, kenian, në Itali prej 3 vjetësh në kërkim të një jete të re i erdhi një ide e mirë, por nuk kishte të ardhura të rregullta dhe mbi të gjitha nuk kishte një garanci. Filloi të punonte në një fabrikë për pak kohë dhe filloi të kryente punë të përkohshme në një kooperativë. Por puna ishte e paktë dhe kontratat ishin gjithmonë prej një apo dy muajsh, dhe nuk i lejonin të vinin mënjëherë paratë për një shtëpi. "Doja të nisja një aktivitet të vogël duke shitur në treg, gjerdane, pareo, veshje të importuara nga Kenia dhe kisha nevojë për një hua për të blerë licencën, të hapja Partita Iva dhe të blija një furgon dhe pak mall. Nga disa miq mora vesh risinë e PerMicro, telefonova dhe më lanë takimin e parë", tregon John. Në fakt PerMicro ka nisur veprimtarinë në fund të vitit

2007 dhe sot është operatori i parë italian që jep vetëm mikrokredit ose *social lending*, veprimtaria e të cilit frymëzohet nga Grameen Bank e themeluar nga Muhammad Yunus, çmim Nobel për paqen në 2006.

Aktiviteti i tij nuk kufizohet vetëm me dhënien e një huaje por njerëzit që i drejtohen PerMicro, marrin edhe mbështetje dhe konsulentë nga ana e operatorëve që ndjekin sipërmarrësit e vegjël në të gjitha fazat e rrugës së tyre, duke iu ndenjur pranë përgjatë gjithë kohëzgjatjes së financimit të tyre.

John fillon kështu bisedimet, ideja e tij verifikohet dhe pjesërisht modifikohet, PerMicro e ndihmon edhe në gjetjen e një furgoni më të përshtatshëm dhe bëhen e ribëhen llogaritjet për të vlerësuar më së miri aktivitetin që dëshiron të ndërmarrë.

Pas pak më shumë se dy javësh vjen edhe drita jeshile: John merr huan dhe mund të fillojë aktivitetin.

Sot shkuam ta takonim në tezgën e tij në treg ku na pritni me buzëqeshje, duke na treguar projektet e tij për të ardhmen, dhe për shtëpinë që arriti të marrë me qira.



**për...
të punuar
më vete**



**për...
të çuar
në shkollë
familjet**



**për...
të rritur
aktivitetin
tim**



**për...
të çuar
në shkollë
familjet**



**për... idenë
time të re**



perXmicro per... fare!
MICROCREDITO IN ITALIA

Deri më 15.000 euro
për ty, për mundësi të mëdha.


Për të nisur apo për të rritur aktivitetin tënd, për të mbajtur familjen larg, për t'u dhënë një të ardhme fëmijëve të tu:
011 658.778 - info@permicro.it
www.permicro.it







PerMicro është shoqëria e parë italiane e specializuar në dhënien e mikrokredive në të gjithë territorin kombëtar. Aktiviteti i Per Micro frymëzohet nga ai i Grameen Bank e themeluar nga Muhammad Yunus, çmim Nobel për paqen në vitin 2006.
PerMicro è autorizzata all'esercizio dell'attività finanziaria ai sensi dell'art. 106 - n. di iscr. 41437.




HORIZONTALISHT

2. Janë litarët e Tarzanit. 5. Mbyllin kurse. 7. Është memece pa kufij. 12. Perëndia egjiptiane që paraqitet si dash. 14. Teket e sitës. 17. Një mund të jetë grossist. 18. Një pluhur vegjetal pikant për kuzhinë. 20. Është hero i përrallave tona. 22. Në hyrje të sallës. 23. Mbyllin një kontrast. 24. Massimo, që qe komik italian. 25. Hroina e Quino-s. 28. Qendra e drogës. 29. Provizore, e përkohshme për... latinët. 30. Jethro që këndojnë Living in the past. 33. Ana që dashuron Wronsky-n. 36. Është tema muzikore e një poeme simfonike. 37. Të gjithë për anglezët. 38. Fillojnë matanë. 40. Para Pulo në Brazil. 42. Në mes të Jean dhe Godard regjisor. 44. Barry i Bee Gees. 46. Vlen katër pikë në rugby. 49. Seleksionohen të parat. 50. Një yll në "timonin" e Qerres së Madhe. 51. Dëshën të përmbysnin carin të tillë.

VERTIKALISHT

1. Një është Figaro. 2. Kovaçi që qe aktor i yni. 3. Një sigël në kryq. 4. Qendër në Panama. 6. Një hidrokarbur. 7. Një llogari. 8. Një Khan i ismailitëve. 9. Një rast kur s'është një as. 10. Një enë. 11. Është i shtatë me kinemanë. 13. Mund të jetë... bonzo. 14. Kështu u quajtën ligjet e Tiberit dhe Gait. 15. Janë binarë. 16. Helmoi veten për të mos rënë në dorë të Shqipon Afrikanit. 19. Është fyese pa fe. 21. Me cannabis është një drogë. 26. Bëjnë dasma me një as. 27. Një demon i pyjeve nordike. 31. Mbarojnë një hall. 32. Këneta e Hidrës. 33. Një markë motoçiklete. 34. Në hyrje të ambientit. 35. Tërhej edhe kështu Zeusi. 37. Oz, shkrimtar izraelit. 39. Një është edhe kodiak. 41. Lodra pa kufij. 43. Bëhet nuse me ne. 44. Georges Dandin. 45. Interpretoi Frankenstein (inic). 47. Ju ndjekin në juri. 48. Kufizojnë pjesët.

Vertikalisht: 1. Factorium. 2. Loro. 3. Int. 4. NA. 6. Etilen. 7. Hesap. 8. Aga. 9. RT. 10. Tas. 11. Art. 13. Murgu. 14. Sempronie. 15. Trajet. 16. Sofonisba. 19. YSE. 21. Satiava. 26. DMA. 27. Troll. 31. LL. 32. Lema. 33. KTM. 34. AM. 35. Liecu. 37. Amos. 39. Art. 41. ODR. 43. Dekabriste. 46. Drop. 49. SE. 50. Mizar. 51. Ail. 38. MA. 40. Sao. 42. Luc. 44. Gibb. 30. Tull. 33. Karenina. 36. Leitmotiv. 37. 25. Mafalda. 28. OG. 29. Protempore. 12. Amon. 14. STS. 17. Tregtar. 18. Cur-ry. 20. Qerost. 22. SA. 23. ST. 24. Troisi. 37. Hurr. 39. AA. 42. EO. 46. Turner këngëtare. 47. Mund të jetë diesel.



HORIZONTALISHT

1. Një diamant artificial. 7. Është shumëllojshmëri gjërash. 12. Një jepet me leksion. 13. Janë të hollat... tona. 15. Ekstreme në ekstreme. 16. Një halucinogjen i njohur. 17. Një komandë në tastierë. 18. Shoqëronin korteur e Cibelës. 21. Haset pa kufij. 22. Nxiti Salomonë të kërkonte kokën e Gjon Pagëzorit. 23. Regjisori i *Më në fund e diel* (inic). 24. Kështu t'rrrej Venediku. 25. Eero, arkitekt i famshëm. 29. Një kalë i egër. 30. Sahat pa kufij. 32. Norma e Martin Ritt. 35. Fisi i indigjenëve i Matto Grosso-s. 36. Lidhet një në qafë. 38. Një ripërtypës i Tibetit. 40. Qe mbreti që vrau eunukun Bagoa. 41. Ishulli i... francezëve. 43. Fundi i një fatziu. 44. Mbyllin aeroporte. 45. Ernst, arkitekt dhe urbanist i famshëm. 46. Turner këngëtare. 47. Mund të jetë diesel.

VERTIKALISHT

1. Graf, ish-kampione e tenisit. 2. Dhjetë... angleze. 3. Nino, kompozitor i njohur. 4. Marsi në areopag. 5. I dëgjoji vetëm Odiseu. 6. Demetra e romakëve. 7. Simon i Duran Duran. 8. Tony, mister quando, quando. 9. Shkroi Didona e braktisur. 10. Francesco saverio, piktor italian. 11. Janë poezi... barbare. 13. Djali i famshëm i Parsifalit. 14. Mbajti një kryq që s'ishte i tij. 19. Dashurohet nga Nemorino. 20. Luarasit aktore. 24. Është gur i arave. 25. Një karrocë në gara hipizmi. 26. Majtas në fund. 27. Kryeqyteti Marokut. 28. Qe biri i famshëm i Eakut. 31. Ian, aktor britanik. 33. Carol aktore. 34. Arthur Gordon i Edgar Allan Poe. 37. Ben i interpretuar nga Charlton Heston. 39. Dy asa në dorë. 42. Diftong në teori.

Horizontalisht: 1. Steffi. 2. Ten. 3. Rota. 4. Ares. 5. Sirenat. 6. Cereje. 7. 12. Teor. 13. Lëkë. 15. EE. 16. LSD. 17. Enter. 18. Konbandet. 21. ASE. 22. Herodiada. 23. FT. 24. Serenissimura. 25. Saarina. 29. Mustang. 30. Kirenat. 19. Adina. 20. Edi. 24. 28. Peleu. 31. Holm. 33. Ail. 34. Pym. 38. Yak. 40. Dart. 41. Ilet. 43. IU. 44. 46. May. 46. Tina. 47. Motori. 48. Drop. 49. SE. 50. Mizar. 51. Ail. 38. MA. 40. Sao. 42. Luc. 44. Gibb. 30. Tull. 33. Karenina. 36. Leitmotiv. 37. 25. Mafalda. 28. OG. 29. Protempore. 12. Amon. 14. STS. 17. Tregtar. 18. Cur-ry. 20. Qerost. 22. SA. 23. ST. 24. Troisi. 37. Hurr. 39. AA. 42. EO. 46. Turner këngëtare. 47. Mund të jetë diesel.

www.stranieriinitalia.it

Faqet internet të emigracionit

Çdo ditë lajme, hulumtime dhe informacione të dobishme për të gjithë të huajt në Itali.



Dashi (21 mars - 20 prill)

Tashmë mund të zgjidhni nëse t'i futeni një pune të vështirë e cila është e rëndësishme për ju, apo t'i kushtoheni argëtimit me të preferuara. Në dashuri mos u nxitoni, personi që ju tërheq mund të mos jetë siç e mendoni; nuk është rasti të merrni vendim të prerë, koha do të tregojë nëse jeni bërë për njeri-tjetrin.



Demi (21 prill - 20 maj)

Nëse doni të bëni figurë të mirë, mund të merrni një iniciativë të guximshme që do të nxjerrë në pah aftësitë dhe bujarinë tuaj të lindur. Bëji një dhuratë dikujt që e ka merituar ngrohtësinë tuaj, do t'ju japë shumë kënaqësi. Në familje jeta do t'ju duket disi e fjetur. Përgatituni për verën edhe me pak gjimnastikë.



Binjakët (21 maj - 21 qershor)

Ky është çasti më i mirë për të hapur një veprimtari private; nëse keni ndërmend një gjë të tillë është mirë ta filloni seriozisht. Me partnerin gjithçka do të sqarohet dhe do të nisni të bëni projekte së bashku. Gjatë këtyre ditëve do t'ju japë kënaqësi shoqëria, darkat apo ndonjë shëtitje me miqtë do t'ju heqë lodhjen.



Gaforja (22 qershor - 22 korrik)

Nëse zemra juaj rreh nga dashuria, këtë fund maji mund të arrini atë që dëshironi. Kushtojini më shumë vëmendje partnerit dhe dëshirave të tij e do të merrni edhe më shumë dashuri. Në profesion çdo gjë do të shkojë mirë edhe nëse nuk do t'i jepni rëndësinë e zakonshme. Mos harroni shokë të vjetër për të rinjtë.



Luani (23 korrik - 23 gusht)

Duke ndjekur me ngulm një ëndërr rrezikoni të mos vini re çka keni në pëllëmbë të dorës, duke shpërdoruar kështu një mundësi të mirë. Tregohuni i matur dhe qëndroni me këmbë në tokë. Në dashuri mos kërkoni të rehat me çdo kusht, një marrëdhënie e konsoliduar mund të rindizet po të dëshironi.



Virgjëresha (24 gusht - 22 shtator)

Mund të veproni me kokën tuaj vetëm nëse i keni idetë të qarta dhe mbështeteni në fakte, duke mos ua vënë veshin thashethemeve; përndryshe pranoni ndonjë këshillë kolegu. Në dashuri, mund t'ju lindin disa dyshime që duhet të sqaroni menjëherë: nëse partneri nuk ju bind, provoni të rini për disa ditë larg.



Peshorja (23 shtator - 22 tetor)

Mund të përballeni me kurajo me një argument thumbues, dhe të hidhni premisat për ta zgjidhur në mënyrën që dëshironi. Në dashuri tregohuni më i duruar, partneri nuk ka gjithnjë të njëjtin mendim me ju, duhet të dëgjoni edhe versionin e tij. Do të keni ndonjë problem shëndetësor si pasojë të lodhjes fizike.



Akrepi (23 tetor - 22 nëntor)

Duke e përballur me ballin lart një problem që deri tani e keni shmangur, mund të çlirohemi nga një peshë e rëndë. Në dashuri, mund t'i ofroni vetes dhe partnerit dëfrime të pazakonta. Mos harroni t'u bëni vizitë prindërve nëse i keni pranë apo t'u telefononi nëse e keni të pamundur t'i takoni. Kujdesuni për shëndetin.



Shigjetari (23 nëntor - 21 dhjetor)

Nëse doni të lëvizni lirisht pa i dhënë kujt llogari për ato që bëni, këto janë ditët më të mira. Do të keni humor të mirë dhe do të kaloni ditë të mrekullueshme me shoqërinë. Partneri nuk do të mirëkuptojë nevojën tuaj për pak "liri". Me punën dhe të ardhurat do t'ju shkojë më së miri pa shumë mundim.



Bricjapi (22 dhjetor - 20 janar)

Do të merrni një shpërblim që do t'ju shtyjë të bëni me më shumë kënaqësi punën tuaj, si edhe të dëshmoni vullnetin tënd të mirë. Në dashuri bëni si t'ju thotë zemra, mund t'i lejoni vetes gjithçka. Në familje ndonjë keqkuptim do të zgjidhet shpejt, mjaft që të dini të dëgjoni vërejtjet e drejta të të afërmeve.



Ujori (21 janar - 19 shkurt)

Mund të vendosni lirisht si t'i shpenzoni kohën e paratë: nuk të mungojnë tundimet, mes të cilave mund të zgjidhni atë që ju tërheq më shumë. Por, mos bëni projekte afatgjata, shumë shpejt situata mund të ndryshojë. Në familje dhe në shoqëri do të jeni gjithnjë në qendër të vëmendjes gjë që do t'ju pëlqejë.



Peshqit (20 shkurt - 20 mars)

Mos e nënvlerësoni një shenjë të fatit që mund t'ju bëjë të ndryshoni sjelljen në lidhje me një çështje pune që ka rëndësinë e vet për të ardhmen e karrierës tuaj profesionale. Në dashuri, mos merrni iniciativa të rrezikshme, partneri mund të mos ju kuptojë. Shëtitjet në ajër të pastër do t'ju kënaqin pa masë.

CATWALK

IL NEGOZIO DI ALTA MODA A TIRANA

Ermenegildo Zegna

CESARE PACIOTTI

GIANFRANCO FERRE

CERRUTI 1881



ONI PUSTINA

RRUGA MYSLYM SHYRI, TIRANA

a mund të dërgoj para
në **shqipëri** me

7€* komision?



transferta nga 100€ për në shqipëri duke filluar nga 7€**

tani edhe nga **toskana**

shuma	komision*
€0,01 - €100	€7,00
€100,01 - €200	€10,00
€200,01 - €300	€13,50
€300,01 - €400	€17,00

shuma	komision*
€400,01 - €600	€26,00
€600,01 - €800	€34,00
€800,01 - €1.000	€44,50

oferta është e vlefshme nga 24 marsi 2009 në të gjitha agjencitë western union në lombardi, emilia romagna, piemonte, liguria, valle d'aosta, trentino alto adige, veneto, friuli venezia giulia dhe toskanë.

* fondet në përgjithësi janë të disponueshme në pak minuta në varësi të afateve dhe kushteve të shërbimit, duke përfshirë dhe oraret e agjencive si dhe ndryshimet në orën lokale, për më tepër shikoni formularin e dërgesës për kufizimet. **përveç komisionit, western union përfiton para shtesë kur këmben paratë tuaja në monedhen vendase. Komisionet standarte fillojnë me 1000.01 euro të dërguara në një transakcion. Për listën standarte të komisioneve ju lutemi, vizitoni agjencitë tona.

WESTERN UNION | *yes!*

familja juaj mund t'ju ndiejë pranë me një transfertë parash, kudo që ju mund të ndodhëni.

+355 42 23 49 79

transfertë parash

gettare negli appositi cestini per proteggere l'ambiente.

www.wu.it

© 2009 WESTERN UNION HOLDINGS, INC. All rights reserved.